



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.05. 2022, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 9, 10 dhe 11 maj 2022.
- Seancë dëgjimore për diskutimin e raportit të veprimtarisë 1-vjeçare për vitin 2021 të RTSH-së.

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Lindita Buxheli, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Eralda Bano, Andia Ulliri, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

Mungon:

Flutura Açka.

Të ftuar:

Leka Bungo – kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH-së,

Mevlan Shanaj – anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së,

Enkelejd Joti - drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Redi Neziri – zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Pandi Madhi - kryetar i Bordit të Administrimit të RTSH-së,

Melsi Qirici - drejtoreshë e Komanduar e Njësisë së Programacionit të RTSH-së,

Bledar Zaganjori - drejtor në Njësinë e Lajmeve dhe Emisioneve Tematike të RTSH-së,
Henri Muça - drejtor i Njësisë Teknike në RTSH.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi - Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin edhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës kemi seancën dëgjimore për diskutimin e raportit të veprimtarisë 1-vjeçare për vitin 2021 të RTSH-së. Ndërkohë, do të fillojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 9, 10 dhe 11 maj 2022.

Nëse nga kolegët nuk ka ndonjë vërejtje, i hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohen.

Çështja kryesore është seanca dëgjimore që sapo përmenda. Nga Këshilli Drejtues i RTSH-së kemi të ftuar zotin Leka Bungo, kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, zotin Mevlan Shanaj, anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së. Nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së kemi të ftuar: zotin Enkelejd Joti, drejtor i Përgjithshëm; zotin Redi Neziri, zëvendësdrejtor; zotin Pandi Madhi, kryetar i Bordit të Administrimit të RTSH-së; zonja Melsi Qirici, drejtore e komanduar e Njesisë së Programacionit të RTSH-së; zotin Bledar Zaganjori, drejtor në Njësinë e Lajmeve dhe Emisioneve Tematike të RTSH-së, dhe zotin Henri Muça, drejtor i Njesisë Teknike në RTSH-së.

Mirë se erdhët!

Sipas mënyrës së menaxhimit të këtyre mbledhjeve, dihet që raporti ka ardhur me shkrim dhe në mënyrë elektronike, por do të fillojmë me një raportim të sintetizuar nga Këshilli Drejtues në fillim, dhe pastaj nga drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së. Dy prezantime të shkurta në dispozicion prej 10 minutash, besoj janë të mjaftueshme.

Zoti Bungo, fjala për ju.

Leka Bungo – Mirëdita dhe faleminderit!

Ka dy versione për fjalën time, një version është nëse ju do të ishit dakord që unë të lexoja një përmbledhje të morsetuar të raportit vjetor, por që është pak i gjatë. Nëse ju keni durim për ta dëgjuar, unë e kam vullnetin për ta lexuar; nëse jo, unë mund të flas në mënyrë më të përmbledhur me fjalët e mia, pa hyrë në raportin me shkrim.

Si e gjykoni të arsyeshme?

Petro Koçi - Ne do të preferonim variantin më të shkurtër, por gjithsesi, vendoseni vetë.

Leka Bungo – Ju e keni përmbledhjen e raportit dhe ndoshta është më mirë të flas me fjalët e mia.

Para se të futem në temë, do të doja të bëja një prolog, që për ju është i njohur, por për të qenë në paqe me veten time, më duket e udhës se duhet ta theksoj edhe një herë për herë të fundit para jush, që jeni organi më i lartë i medias.

Unë i jam drejtuar Këshillit Drejtues dhe deputetëve të Kuvendit nëpërmjet shtypit, nëpërmjet ekranit të televizionit, edhe këtu, në këtë komision, disa muaj para kam shprehur mendimin tim, që për të bërë reformë në RTSH ka vetëm një rrugë, gjithmonë sipas meje, dhe ajo reformë mund të bëhet vetëm nëse RTSH-ja, e cila ndër të tjera ka një organikë shumë të madhe me një personel shumë të gjerë, që aktualisht janë në pozicione pune, Kadareja thotë: “Në çdo sistem, më shumë në atë socialist, lufta ndërmjet të paaftëve është lufta më e egër dhe gjithmonë fitojnë të paaftët”. Unë do të doja të thosha që përderisa në ligjet e Kuvendit të Shqipërisë nuk ekziston asnjë ligj, i cili merr përsipër që të realizojë eliminimin e të paaftëve nga një institucion i tillë, si rrugë të vetme unë shoh mundësinë për ta mbyllur RTSH-në ose në kllapa, në të vërtetë them për ta hapur, të paktën për 3 muaj të zgjidhen 3 komisione, 1 teknik, 1 gazetarie dhe 1 krijues me të huaj në përbërje, nga 1 shqiptar secili dhe të tjerët të huaj, të dalin të shkojnë të gjithë në shtëpi, të rrinë 3 muaj dhe pas 3 muajve të vijnë të gjithë të aplikojnë me alfabet dhe ata që e meritojnë, le të futen, të tjerët të ngelen. Ky ka qenë dhe ngelet mendimi im. Unë jashtë këtij mendimi, çdo tentativë tjetër për reformë e quaj të pamundshme. Ky ishte prologu.

Lidhur me aktivitetin e RTSH-së dhe me aktivitetin e Këshillit Drejtues në RTSH, jam i detyruar të koncentrohem në gjashtë muajt e vitit 2021 që njohim, sepse pjesa tjetër ka qenë e panjohur për ne. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe unë mendoj se Këshilli Drejtues është përpjekur me seriozitet dhe profesionalizëm për të bërë njëfarë kthese nga gjendja në të cilën sipas meje u gjet institucioni i RTSH-së. Në këtë drejtim janë bërë disa përmirësime të dukshme. Ajo që dua të theksoj dhe që për mua është një nga meritat kryesore që ka RTSH-ja sot aktualisht, është depolitizimi i ekranit dhe mikrofonit të saj. Ka një përzgjedhje reale ndërmjet forcave politike në të gjitha emisionet, kryesisht në emisionet informative. Mendoj se anësi politike mund të gjesh shumë më tepër në televizionet private se sa në RTSH dhe kështu duhet të ishte në parim, por nuk ka qenë kështu në të shkuarën.

Ndërsa, unë mendoj se kjo plagë është shëruar, megjithatë kjo lë shteg për të menduar që nuk është bërë gjithçka e mundur. Kjo është një nga pikat kryesore duke e gjykuar si një institucion nga më të mëdhenjtë mediatik që ka vendi ynë.

E dyta, mendoj se ngelet shumë ne jemi përpjekur, por nuk e kemi arritur për përmirësimin e punës në krijim të produksionit artistik në RTSH. Mendoj se është bërë shumë pak për këtë. Me gjithë përpjekjet, debatet, që ngelen debate, me gjithë propozimet, që ngelen propozime; mendoj se nuk është bërë e duhura dhe për pasojë në ekranin tonë ka mangësi, që unë mendoj se duhen rregulluar me urgjencë dhe kuraje.

Stafi i ri që ka ardhur në drejtimin ekzekutiv të RTSH-së ka vetëm 6 muaj që ka filluar punë dhe mendoj se barra më e rëndë u bie produksionit. Çdo gjë në atë institucion prej 1150 punonjësish bëhet për atë ekranin e vogël, edhe ai bojaxhiu, edhe regjisori, drejtori, operatori, të gjithë punojnë për atë ekran. Në qoftë se telekomanda nuk hap atë ekran, atëherë ne nuk e kemi kryer misionin tonë. Sipas meje, ngelet shumë. Motivet ju i dini, nuk kam nevojë të zgjatem, por thjesht për kujtesë, ne kemi një marrëdhënie financiare me njerëzit, që është fare e pavolitshme për të tërhequr gazetarë, regjisorë, skenaristë e të tjerë krijues në ekranin tonë, ndërkohë që privati e ka shumë të thjeshtë. Fakti që gazetarët më të mëdhenj të Shqipërisë kanë lindur në atë ndërtesë dhe janë transferuar në televizione private për arsye thjesht financiare e tregon këtë.

Unë mendoj se mungojnë mekanizmat për zgjidhjen e këtij problemi, mund të ketë dëshirë, por mekanizma nuk ka.

E treta, sipas mendimit tim, legjislacioni dhe për rrjedhojë statuti i RTSH-së mënjanon nga autoriteti Këshillin Drejtues. Këshilli Drejtues, sipas ligjeve në fuqi dhe sipas statutit, është as më shumë dhe as më pak po një noter, i cili është i detyruar të ngrejë dorën për çdo propozim që bëhet ose të mos i aprovojë ato, ama, ekzekutivi, Drejtoria e Përgjithshme është gjithçka.

Unë mendoj që, për hir të mbarëvajtjes në punë, të reformës reale në RTSH, duhet riparë legjislacioni. Mendoj se ka nevojë për ndërhyrje në legjislacion.

Mund t'ju them vetëm dy-tre shembuj të thjeshtë, që nuk kanë ndonjë vlerë të madhe. Drejtoria e Auditimit varet nga drejtori i Përgjithshëm, që këtu në ligj është mbrapsht. Bordi i Administrimit propozohet nga drejtori i Përgjithshëm, miratohet nga Këshilli Drejtues dhe është këshilltar i Këshillit Drejtues. Janë disa gjëra që nuk kanë sens ligjor sipas meje, por ajo çka është kryesorja, që unë mendoj se do të ndikojë në ardhmërinë e ekranit të RTSH-së, është rishikimi i mekanizmit financiar, për mua ai është baza, të tjerat janë fjalime, janë hartime, mund të themi

kemi qenë mirë, jemi shumë më mirë, kemi qenë keq, do të bëhemi më mirë, por këto do të ngelen gjithmonë në protokollet e Komisionit të Medies.

Unë mendoj se është koha të kryhen veprime reale dhe iniciativë më mirë se ju që jeni Komisioni i Medies, nuk mund ta marrë kurrkush. Edhe ata që te ne janë përgjegjës të Sektorit Juridik nuk kanë atë përvojë, ose nuk janë aq të specializuar në këto çështje se ç'janë atë që janë nën varësi të Kuvendit të Shqipërisë. Unë do ta kërkoja ndihmën tuaj në këtë drejtim në mënyrë praktike, jo me këshilla.

Për ata mbyllur, kemi bërë një kërkesë drejtuar komisionit tuaj, ne na mungojnë dy anëtarë për të plotësuar numrin e saktë të Këshillit Drejtues dhe u bënë muaj që e kemi kërkuar dhe ende nuk e kemi. Ju lutem shumë, të gjeni mundësinë për ta rishikuar këtë që t'i kemi edhe këta dy anëtarë në Këshillin Drejtues.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Bungo!

Fjala për drejtorin e Përgjithshëm, zotin Joti.

Enkelejd Joti – Përshëndetje të gjithëve!

Mbledhja tani po zhvillohet për raportin e vitit të shkuar, kështu që unë i bie të flas për të ardhmen.

Petro Koçi – Ideja është që këtu raportohet për vitin 2021, dhe pavarësisht faktit që ju nuk jeni drejtor si vit kalendarik për gjithë vitin 2021, gjithsesi raportoni si institucion. E kuptoj aspektin tuaj personal ose keqkuptimet që mund të krijohen, por ky është raportim, duke përfshirë edhe atë që thatë ju, pra, na thoni sugjerimet tuaja ose çfarë mendoni për të ardhmen.

Enkelejd Joti – Do të thosha se për sa i përket pjesës financiare, meqenëse është edhe kryetari i Bordit të Administrimit, i cili ka qenë për një periudhë relativisht të gjatë, mund të bënte një prezantim më sintetik të vlerave, ku, siç tha edhe kryetari, zoti Bungo, një nga nevojat imediate që ka RTSH-ja është financimi, që do të bënte të mundur rifutjen në treg të RTSH-së, të cilit i mungojnë projektet artistike, që janë gjëja më kryesore, spektaklet, të cilat, fatkeqësisht, janë në mënyrë të papërfillshme ato që janë aktualisht dhe kanë nevojë imediate për vëmendje.

Kjo është një nga gjërat, ndërkohë, pjesë e financimit duhet të jetë edhe lidhur me pagesat e stafeve për të cilët, në qoftë se ne duam të jemi konkurrentë në treg, nuk mundet të konkurrojmë dhe të marrim personalitete, të cilët në treg, nga televizionet private marrin disafishin e pagës që

ne kemi realisht. Kështu që, është një konkurrencë e pandershme, në fakt, dhe e pamundur për ne për të bërë realitet atë ambicie që ne kemi, qoftë si staf, qoftë si të gjitha televizionet.

Lidhur me pjesën e financimit, do të ishte mirë të fliste zoti Madhi për sa i përket pjesës së të shkuarës, sa i përket të ardhmes, siç e thashë, ritheksoj, është tejet i rëndësishëm gjetja e mekanizmit financiar, po perifrazoj atë që tha zoti Bungo, për RTSH-në, nëse duhet të jetë konkurrent në treg. Në të kundërt, pastaj, do të bëjmë përpjekje maksimale, por që realisht, përveç një suksesi që RTSH-ja e ka arritur në këto vite, që ka qenë paanshmëria politike, dhe nuk i heq asnjë presje asaj që tha zoti Bungo, që RTSH-ja është më i paanshëm se çdo media tjetër, gjë e cila duhet vlerësuar nga të gjithë, besoj.

Këtë besoj mund ta keni vënë re edhe ju, si pjesë e politikës, nëse keni pasur mundësi ta ndiqni.

Sfida është jo e vogël. Aktualisht RTSH-ja ka një numër të madh kanalesh dhe ne nuk konkurrojmë vetëm thjesht me televizionet, por konkurrojmë edhe me platformat televizive që janë në treg, dhe kjo për t'u ardhur në ndihmë atyre qytetarëve, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të pasur një paketë me pagesë, që është edhe një nga misionet që ka RTSH-ja.

Një nga gjërat që do të doja të prekja, përveç pjesës së financimit që ka pjesën e infrastrukturës, pjesën e pagave, është edhe arkiva e Televizionit Shqiptar. Mendoj se është një aset kombëtar, ku kanë dhënë kontributin e vet të gjithë artistët shqiptarë, të gjitha veprat artistike që janë vënë që kur ka filluar televizioni dhe deri më sot, një pjesë e tyre janë disa formate, të cilat, fatkeqësisht, nuk ekzistojnë dhe ne detyrohemi që të marrim asistencë nga jashtë dhe të bëjmë investime ekstra. Televizionet rajonale publike, një pjesë e madhe e tyre kanë arritur të kryejnë digjitalizimin, e kanë nisur para 5 vjetësh apo 10, ku një pjesë e tyre e kanë përfunduar, pjesa tjetër janë në proces. Ky është një proces që zgjat me vite, për shkak se janë miliona metra film, të cilat nuk keni mundësi t'i digjitalizojmë me pajisjet që kemi.

Kështu që, kjo mendoj se është një prioritet që nuk duhet të jetë thjesht e RTSH-së, por, sikundër edhe vende të rajonit e kanë quajtur si trashëgimi kulturore dhe e kanë marrë me seriozitet dhe kanë krijuar infrastrukturën e përshtatshme dhe trajnimin e njerëzve përkatës për ta realizuar këtë.

Kaq kisha në vija të përgjithshme, pastaj, në qoftë se keni pyetje, jam i gatshëm t'ju përgjigjem.

Petro Koçi – Do të fillojmë më pas me seancën e pyetjeve.

Fjala për zotin Madhi, meqenëse ju jeni më specifikisht i ngarkuar me çështjet e financave.

U tha që çështja e mekanizmave financiare është një problem, pra mënyra se si veprohet financiarisht me të ardhurat e njerëzve që angazhoni, apo ndoshta edhe çështja e projekteve. Ideja është që kërkohet buxhet më i madh, apo kërkohet lirshmëri, të themi, në mënyrën se si buxheti administrohet nga ju?

Pandi Madhi – Faleminderit, zoti Koçi!

Do të përpiqem shkurtimisht të paraqes se çfarë ka ndodhur nga pikëpamja financiare gjatë vitit 2021, ka qenë një vit, i cili i ka përmbushur nga pikëpamja financiare relativisht mirë shpenzimet e RTSH-së. RTSH-ja ka një buxhet në ekuilibër, sa janë të ardhurat, aq janë edhe shpenzimet dhe gjithmonë ky detyrim që ka RTSH-ja zbatohet vit pas viti dhe ndodh që gjithmonë të ardhurat janë pak më të larta se sa shpenzimet.

Gjatë vitit të kaluar në të ardhurat e RTSH-së ka pasur mosrealizime. Këto mosrealizime kanë ardhur nga mosarkëtimet e duhura nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive që arkëtohet nga OSHEE-ja dhe disa diferenca edhe nga të ardhurat e vetë RTSH-së, pavarësisht që ishte Kampionati European, përsëri janë krijuar disa mosrealizime. Tri janë burimet e të ardhurave të RTSH-së: financimi nga buxheti i shtetit, tarifa e përdorimit të aparateve televizive dhe të ardhurat që realizon vetë RTSH-ja nga sistemi, nga qiratë, nga reklamat, publiciteti dhe disa të ardhura të tjera të vogla, që konsiderohen si të ardhura të tjera.

Vazhdon të mbetet problematike arkëtimi në masën e parashikuar nga OSHEE-ja. Ju jeni në dijeni edhe për propozimet tona lidhur me OSHEE-në për uljen e komisionit të arkëtimit që mbajnë nga 10% të ulet, siç e kanë edhe vendet e tjera, siç e kanë edhe struktura të tjera në Shqipëri, që të jetë në nivelet 1% apo 2%, kjo është shumë e rëndësishme, se kjo i jep një të ardhur shtesë RTSH-së të merituar. Pra, nga arkëtimet që bëhen nga OSHEE-ja nga tarifa që kemi në faturat e energjisë 100 lekë në muaj, 10% e saj mbahet nga OSHEE-ja, që prej fillimit të arkëtimit të kësaj tarife.

Po kaloj te pjesa e shpenzimeve. Pjesën dërrmuese të shpenzimeve në RTSH e kanë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, që zënë afërsisht 45%, pastaj janë shpenzime fikse të tjera materiale, mekanizma ndërkombëtarë që duhen paguar, që edhe këto zënë një pjesë relativisht të konsiderueshme.

Pjesa e investimeve dhe e mirëmbajtjes, kjo e fundit veçanërisht është një shpenzim fiks i rrjetit të digjitalizimit që dihet që është 270 apo 280 milionë lekë të rinj në vit, një pjesë e së cilës

përballohet nga buxheti i shtetit, 200 milionë, pjesa tjetër nga RTSH-ja. Përveç kësaj, RTSH-ja ka edhe detyrimin për të paguar këstin e kredisë së marrë në kuadër të procesit të digjitalizimit, që edhe kjo shkon rreth 2 milionë e gjysmë euro në vit, që RTSH-ja, për fat të keq, këto vitet e fundit nuk e ka paguar, por e ka paguar Ministria e Financave, e cila është garanti i kredisë, pikërisht, sepse nuk janë bërë të mundur arkëtimet e duhura nga OSHEE-ja, që është një nga faktorët kryesorë. Ne i kemi analizuar, janë bërë diskutime edhe me OSHEE-në, por duhen vijuar dhe duhen dhënë disa përfundime që të ndikojnë në rritjen e të ardhurave të RTSH-së, sipas nivelit të parashikuar, se këtu është problemi, ne s'po kërkojmë që të tejkalohen të ardhurat, por të paktën të realizojmë ato të parashikuarat. Parashikimet janë objektive, nuk janë subjektive, por ka disa probleme që duhen trajtuar dhe duhen zgjidhur.

Ne i kemi analizuar në mënyrë ritmike çdo tre muaj qoftë Këshilli Drejtues, qoftë drejtori i Përgjithshëm, por edhe Bordi, i cili e ka si detyrë detyrimin e ka edhe muajor, por është e pamundur të bëhet muajor për shkak të përgatitjes nga sektorët përkatës në RTSH të të dhënëve mujore. Ndoshta në një periudhë të ardhme mund të realizohet kjo. Kemi vijuar me analizat tremujore ku jemi përpjekur të japim disa zgjidhje, disa rekomandime. Situata është siç e paraqiti edhe kryetari i këshillit dhe drejtori dhe kërkohet një mbështetje. Mbështetja qoftë edhe nga buxheti i shtetit ka ardhur në rënie vit pas viti, por janë disa komponentë që buxheti duhet t'i përballojë, siç është mirëmbajtja e rrjetit të digjitalizimit, një shumë e vogël modeste është edhe për orkestrën e RTSH-së, të cilët i shërbejnë të gjithë shoqërisë së kulturës shqiptare. Pra, janë detyrime ligjore. Ajo që kërkohet është që buxheti i shtetit të marrë përsipër disa detyrime ligjore që ka për të mbështetur projektet lidhur me RTSH-në. Pra, nuk flitet për të pasur lirshmëri. Këtu janë shumica, po themi, 80% e shpenzimeve janë detyruese, pothuajse janë fikse, për shembull pagesat për energjinë dhe ujin janë pothuajse në të njëjtat shuma. Pra është bërë një punë e madhe, sepse, në fakt, ata vit pas viti vijjnë duke u ulur, pavarësisht se çmimet janë rritur, ka pasur një administrim korrekt. Problem është çështja e fondeve për projektet artistike dhe filmike, të cilat janë dhe qëllimi final i atyre që prezantohen në ekran. Këto projekte shuma është diferenca e të ardhurave me gjithë këto shpenzimet që parashtrohen, pra çfarë mbetet, qoftë për projekte qoftë edhe për investime. Kështu që gjërat janë shumë të limituara. Gjithmonë operojmë me diferencat. Ata që mbetën shkojnë për projekte. Për shembull për projekte shuma çdo vit është 300 milionë lekë të rinj në një buxhet që është 2,3-2,4 miliardë lekë të rinj në vit.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Madhi!

Para se t'ia jap fjalën kolegëve më duhet të them se RTSH-ja është një aset shumë i rëndësishëm për të cilin taksapaguesit, për shkak të detyrimit ligjor, janë të angazhuar drejtpërdrejtë, ndryshe nga televizionet e tjera jopublike, me të cilët qytetarët lidhen sipas interesit tregtar ose interesit artistik, kështu që detyrimi juaj është i jashtëzakonshëm, sepse është detyrim ligjor. Para se të fillonim këtë mbledhje, meqenëse do të drejtoja, kisha një dilemë se çfarë të bëja me mosplotësimin formal të raportit që ka lidhje, së pari, me një raport që duhet të bëjë Këshilli për shikuesit dhe drejtuesit sipas ligjit. Ky është një raport që i paraqitet Kuvendit, por që nuk ka ardhur në Kuvend. Në faqen zyrtare nuk ka të dhëna, sipas raportit që na bën ne Shërbimi i Monitorimit i Kuvendit, në lidhje me veprimtarinë e këtij Këshilli.

Së dyti, është një raport tjetër që i paraqitet AMA-s, por i vjen si kopje edhe Kuvendit, që është raporti për fondin e prodhimit të pavarur, ku thuhet se brenda tri muajve nga përfundimi i vitit financiar duhet të përfundohet dhe t'i paraqitet AMA-s. Edhe këtë raport ne nuk e disponojmë.

Së treti, është mosraportimi për përmbushjen e rekomandimeve të KLSH-së. Ju i dini mirë pasojat penale që kanë ndodhur pas kontrolleve të KLSH-së dhe këtu ka një element që më ka çuditur. Në raport thuhet se të ardhurat e parashikuara nga shitja e biletave nuk janë arkëtuar gjatë vitit 2021 dhe mbarten të realizohen dhe arkëtohen në vitin 2022. Këtë nuk e kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e çuditshme. Gjithsesi është shpjegim që mund të na vijë më vonë.

Një problem tjetër është çështja e transparencës në veprimtarinë e Këshillit, sepse në faqen përkatëse nuk është publikuar as rregullorja, as rezolutat përkatëse të Kuvendit, plani i biznesit për vitet 2021-2025, nuk është publikuar raporti vjetor financiar për vitin 2021 dhe shumë çështje të tjera. Unë e di se mbledhjet e Këshillit nuk regjistrohen, por është mirë të regjistrohen dhe të administrohen. Gjithashtu, më thonë se nganjëherë nuk është shumica e Këshillit, kur shqyrtohen projektvendime dhe pastaj bashkëfirmosen më vonë nga anëtarët e tjerë. Uroj që kjo të mos jetë e vërtetë. Gjithsesi kjo ka të bëjë edhe me legjislacionin. Pra, ne duhet të ndërhyjmë mbase në legjislacion për t'i bërë disa procese më detyruese dhe jo të varen nga vullneti i individëve të caktuar.

Gjithsesi, nëse keni ndonjë përgjigje për këto çështje, mund të përgjigjeni. Pastaj do të vazhdojmë me kolegët.

Leka Bungo – Këshilli i Dëgjuesve nuk ekziston, të paktën unë nuk e di që ekziston. Ai ka qenë formal, siç kanë qenë shumë organizma formale në RTSH dhe vazhdojnë të jenë i tillë.

Ndërsa për atë që ju thoni, lidhur me mbledhjet e Këshillit Drejtues të RTSH-së, ato janë llafe pazari që ju kanë ardhur juve në vesh, nuk kanë asnjë lidhje me realitetin. Fakti që vendimet që merren në KDRTSH, merren *dal vivo* atje dhe janë prezent të gjithë. Mundet që kjo të jetë keqinterpretuar ndoshta me dashje apo pa dashje. Të gjitha mbledhjet e këshillit drejtues që nga momenti që unë të paktën jam atje janë të regjistruara dhe janë të ruajtura në kompjuter.

Së dyti të gjitha vendimet që ka marrë këshilli drejtues nuk janë firmosur sapo ka mbaruar mbledhja sepse është votuar aty për arsye teknike, për të mos ndenjur edhe nja dy orë sa t'i hedhin nga kompjuteri, janë firmosur të nesërmen ose të pasnesërmen, por janë të pasqyruara me imtësi, jo vetëm në regjistrim por edhe në protokoll. Ne mbajmë protokoll dhe protokollin është emër për emër votë për votë ditë për ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sa i përket çështjes tjetër që ju ngritët, fajin e kam unë dhe kërkoj ndjesë, sepse është një gjë që mund ta riparoj dhe që lidhet me pasqyrimin në faqen zyrtare të RTSH-së të aktiviteteve të këshillit drejtues. Kjo është detyra ime dhe këtë unë e nuk e kam bërë për neglizhencë, por them që mund ta riparoj, por nuk e kam vlerësuar këtë, sepse kam menduar se është kryer misioni duke qenë atje dhe duke marrë vendime.

Petro Koçi – Po rekomandimet e KLSH-së?

Leka Bungo - Ajo është çështje komike, është humor, mendoj unë. KLSH-ja bën vërejtje te ne, unë e kam raportin e KLSH-së dhe ekzekutimin e vërejtjeve ia lë në dorë drejtorit të përgjithshëm, i cili thotë se këtë e shoh të arsyeshme, por këtë jo. Këtë nuk e kuptoj dot. Me fjalë të tjera konkretisht për këtë që thoni ju konkluzionet e Këshillit Drejtues ishin fjalë për fjalë, që për drejtorin e Përgjithshëm Thoma Gëllçi ne nuk kemi as nuk japim asnjë mendim, sepse ai është larguar nga detyra. Për mua kjo është një mungesë përgjegjësie nga ana e KLSH-së. Iku ai erdhi ky tjetri, Martin Leka. Tani, atij ia çojnë raportin e Këshillit Drejtues, ai thotë kam vërejtje për Leka Bungon e filanin e filanin. Por e bukura është se emrin e Leka Bungos e thotë, por këto dy të tjerët jo. Po pse? Çfarë është kjo marrëdhënie?

Nëse unë them që ai që e bën rekomandim për mua, unë them mos e shëno. Unë nuk e di, nuk e kuptoj këtë marrëdhënie, sa i përket vërejtjeve të KLSH-së.

Petro Koçi – Unë besoj se KLSH-ja ka rekomandime edhe për mënyrën e administrimit të gjërave, jo thjesht për vërejtjet ndaj personave të caktuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Boçi, fjala për ju.

Luçiano Boçi – Procedura prevalon dhe përcakton rregullat e komunikimit. Drejtuesi i komisionit nuk duhet të shfrytëzojë pozicionin e të qenit drejtues, për ta marrë fjalën i pari në raport me të gjithë anëtarët e komisionit. Ka ndodhur disa herë kjo. Unë nuk e kam bërë këtë vërejtje në shërbim të krijimit të një klime pozitive të komunikimit tonë në raport me çështjet ligjore, seancat dëgjimore e të tjera. E marrin fjalën anëtarët pastaj drejtuesi dhe kryetari. Nëse ka pyetje të vetat, mund t'i bëjë ose mund të përmbledhë pyetjet. Ai raport është i monitorimit. I vihet në dispozicion çdo deputeti, i cili e shfrytëzon për të pasqyruar shqetësimet në lidhje me RTSH-në. Nuk e kam vetëm për këtë seancë e kam edhe për seancat e tjera që janë bërë. Kjo metodë duhet të ndryshojë.

Petro Koçi – Për këtë dua të sqaroj që ishte çështja e plotësimit formal të raportimit, nuk ka lidhje me përmbajtjen. Kur të fillojë përmbajtja, kemi pyetje të tjera. Problemi është se mungon pjesa formale.

Luçiano Boçi – Petro, e kisha për procedurë.

Petro Koçi – Këto raportime na mungojnë, pra nuk është fjala te cilësia dhe te përmbajtja.

Luçiano Boçi – E kisha për procedurë, nuk e kisha as për përmbajtjen, as për raportimin, por për procedurën e komunikimit në komisione, sepse ka ndodhur disa herë dhe unë mendova se ky është piku që unë duhet ta them, sepse u zbraz gota dhe po them që, të lutem, fjala i takon anëtarëve të komisionit. Drejtuesi bën pyetjet e veta në fund fare, si konkludim, ose pyetje personale të tij.

Kjo ishte ajo që unë doja të theksoja. Thjesht për të ruajtur balancën, jo se prish gjë, por është protokoll i mënyrës si funksion komisioni.

Petro Koçi – Po kjo nuk ka lidhje fare me balancën. Unë e preferoj shumë balancën, madje preferoj që nga opozita të ketë më shumë gjenerim çështjesh dhe diskutimesh. Thashë edhe një herë është për çështjen plotësimit formal të raportimit jo për përmbajtjen. Në plotësimin formal mungonin disa raporte që janë detyrime formale të trupave, që, siç u tha edhe nga përgjigjja, në ndonjë rast nuk ekzistojnë fare, siç është këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit.

Pra, në pjesën e parë të konstatimeve që ka vënë bordi mungojnë këto gjëra. Të përmbajtja pastaj është çështje tjetër, hajde të diskutojmë dhe të fillojmë nga pyetjet.

Zoti Ajazi.

Besion Ajazi – Faleminderit!

Në cilësinë e relatorit të kësaj mbledhjeje ku diskutojmë raportin vjetor të RTSH-së, para se të them dy fjalë rreth raportit, do t'i kthej një përgjigje zotit Bungo që ngriti shqetësim për dy vendet vakante në KDRTSH. Komisioni e ka hapur procedurën, janë paraqitur disa kandidatë. Drejtorja e Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit është në fazën e verifikimit të kriterëve dhe besoj se javën tjetër nisim si komision procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve që i takon sipas ligjit një maxhorancës dhe një opozitës.

Besoj se një relativitet më të plotë do të kemi në seancën e radhës të komisionit, ku do të dalim edhe me një rezolutë për aktivitetin tuaj për vitin 2021, por edhe rekomandimet që do të kemi për vitin 2022. Si fillim dua të vlerësoj punën e deritanishme të RTSH-së sa i përket informimit të qytetarëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë, bërë kjo me profesionalizëm; sigurisht edhe pjesën e programacionit, sa i përket vetëm kanaleve të dedikuara në arsim, në kulturë dhe sport, duke ditur dhe duke vënë theksin veçanërisht te kanali i dedikuar për arsimin që i ka dhënë një ndihmë të madhe edhe fëmijëve dhe nxënësve në të gjithë Shqipërinë në kohën e pandemisë. Sigurisht edhe unë, si ish-gazetar, i bashkohem shqetësimit të zotit Bungo dhe zotit Joti lidhur me varfërinë e spektakleve të programacionit artistik.

Aty ka njerëz shumë të mirë dhe punëtorë, por edhe profesionistë, por ndoshta ajo që ju theksoni, problemi i financave, është ai që e shkakton këtë varfëri në programacionin artistik.

Megjithatë unë personalisht do t'ju mbështes për çfarëdolloj kërkesë që ju do të keni drejtuar komisionit tonë dhe ju mbështes në emrin tim personal edhe për një fikje ose një pezull të televizionit për riformatim.

Unë jam i mendimit që televizioni ka burime njerëzore shumë të afta dhe shumë të mira, që e kanë drejtuar dhe punuar deri sot, por ndoshta një shpërndarje më e mirë, por edhe prurje të reja do t'i bënin mirë televizionit në tërësi.

Sigurisht ne do të bëjmë seancën e pyetje - përgjigjeve, do të marrim informacion për pyetjet që do të bëhen në lidhje me punën tuaj dhe do të dalim edhe me një rezolutë në seancën e komisionit të datës 30, prandaj nuk dua të jem i nxituar në fjalën time, por ato që tha edhe zoti Koçi, disa gjetje që janë shënuar nga Shërbimi i Monitorimit për raportin tuaj ekzistojnë dhe do të

ishite mirë të qartësoheshim edhe nga ju për mosrealizime ose mosarritje të rekomandimeve që ky komision ka lënë për vitin 2021.

Pra, do të dëgjojmë përgjigjen tuaj, pastaj do të hartojmë rezolutën për vitin 2022 që është edhe baza e punës suaj për vitin e ardhshëm.

Petro Koçi- Zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Ne, si komision, duhet të jemi, së pari, mbështetës të aktivitetit të RTSH-së dhe këtë mbështetje nuk duhet ta shtrijmë thjesht në momentin e raportimit, por gjykoj që momenti më kryesor do të ishte momenti i miratimit të buxhetit në raport me financimin nga buxheti i shtetit të RTSH-së. Në memorien time kërkesat për shtimin e financimit ndaj RTSH-së kanë qenë të vazhdueshme dhe gjatë këtij viti dhe ajo gatishmëria nuk duhet të jetë vetëm me fjalë, por duhet të jetë vendimmarrëse dhe ne kemi kërkuar që ky komision të shprehet saktësisht, madje të llojë për atë që konsiderohet mbështetje financiare e RTSH-së. Sigurisht RTSH-ja ka shumë probleme. Duhet pranuar që është përfaqësuar në një formë të re, me digjitalizimin, me pasjen në pronësi të dy rrjeteve frekuencore të shtimit të kanaleve të programeve që janë meritë e menaxhimit të stafit dhe, pse jo, edhe financimi i tij me kredi apo realizmi i kërkesave të BE-së në raport me digjitalizimin. Por, megjithatë, televizioni publik ende nuk është ngritur në nivelin e konkurrencës që pretendohet nga specialistët, por edhe nga publiku. Shikueshmëria nuk është rritur dhe aq në raportimet që ne kemi, megjithëse është televizioni që ka shtrirjen më të madhe në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe cilësia ka ceduar, pavarësisht disa arritjeve në raport me informimin e publikut, në raport edhe me balancën politike të informimit të publikut. Këto gjëra duhen evidentuar si detyrë institucionale. Këtë e ka, në fakt, në dorë RTSH-ja që mund ta konsiderojë pjesë të raportimit, megjithëse besoj se është pjesë e raportit të paraqitur. Shoh një lloj situatë konfliktuale ndërmjet drejtuesve të RTSH-së, ndoshta në raport me raportimin. Është hedhur ideja e fikjes që unë e dëgjova nga zoti Ajazi, pra e fikjes tremujore. Ky më duket populizëm i pastër. Nuk ka pse një institucion i cili ndërtohet mbi parime standarde, kritere, ligje, rregullore, u dashka patjetër që të fiket tre muaj dhe më pas të zerojmë gjithçka, ta nisim nga zero për të gjetur staf teknik, ato elemente që ndihmojnë ngritjen e një radiotelevizioni. Them se është një ide e mirë për *skup* gazetaresk, për lajm. Të gjithë mediet *online* e kanë këtë lajm, se ka bërë jehonë që më përpara dhe besoj se bën edhe sot. Por nuk është kjo zgjidhja, sepse ka një konfliktualitet. Ndërsa ju shtroni dhe parashtroni që RTSH-ja arrin të informojë mirë publikun në raport me qëndrimet

politike, do të thotë që ka arritje. Dhe në vërejtjet tuaja thoni se nuk ka fonde buxhetore që RTSH-ja të ngrejë cilësinë. Atëherë, ja ku është çelësi, pra RTSH-ja nuk paska fonde buxhetore, sepse nëse ju në raportin tuaj do të thoni se të gjithë të metat vijnë për shkak se stafi është i papërgatitur, i pa trajnuar, i dobët e të tjera, atëherë po unë do të isha dakord të merrnim masa kriteresh zgjedhjesh, përzgjedhjesh. Por kriteret përcaktohen nga KDRTSH-ja për përcaktimin e drejtorëve. Pra, ju keni kriteret, filtrat për të marrë burimet njerëzore më të mira që ekzistojnë në tregun shqiptar dhe për t'i punësuar në RTSH, por paga është kaq e vogël, sa aplikuesi nuk vjen. Pra, problemi është financiar në rastin konkret. Është ajo që ju e kërkoni, ne e mbështesim. Ky është opinionimi im.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mos hyjmë në replikë!

Unë jam në kundërshtim me atë ide.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë me përgjegjësi politike po flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u emociononi kot, sepse nuk po të fyej fare.

Leka Bungo – Jo të më fyesh, por nuk duhet të tentosh të më fyesh mua...

Luçiano Boçi - Më vjen keq, pse e more për fyerje, sepse e thashë si ide?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Leka Bungo – Si të mos fyhem? Unë e kam menduar mirë atë punë, por ti nuk e kupton dot dhe nuk ke faj!

Petro Koçi – Zoti Bungo, do ta merrni fjalën kur t'ju jap unë.

Leka Bungo – Më falni, gabova!

Luçiano Boçi – Në fakt, për procedurë drejtuesi duhet të ndërhynte më shpejt, sepse tek e fundit zoti Bungo, pavarësisht pozicionit dhe dijeve tuaja, këtu jeni para komisionit dhe jemi në pozicione të përcaktuara qartë. Ju jepni llogari para komisionit, pavarësisht se kush janë deputetët dhe çfarë stime keni ju për deputetët, kjo nuk varet nga ju, por nga fjalët që do t'ju them. Unë nuk kam si qëllim t'ju fyej, sepse këtë e përmendi edhe zoti Ajazi, kështu që revolta ime nuk është për ty, por për zotin Ajazi që u largua, sepse ai është njeri politik dhe më revoltonte, kurse ju keni vlerësimin tuaj, jeni aty dhe kjo është çështje e organizimit tuaj.

Meqenëse jemi te veprimtaria e KDRTSH-së, unë u bashkohem shqetësimeve të raportit të monitorimit dhe kam disa vërejtje të tjera. Ky raport, sipas ligjit, ne i referohemi ligjit, neni 102, pika 18 e përcakton qartazi, për veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar dorëzohet në muajin mars, në ligj është e përcaktuar qartë në fund të muajit mars, sot jemi në maj dhe ky raportim është jashtë afateve ligjore. Do të thuash që ky është një detaj, po është një detaj, aty ka edhe detaje të tjera, që e pengojnë pikërisht këtë bashkëpunim dhe ecuri.

Siç jua thashë edhe në fillim, ne nuk jemi penalizues dhe nuk jemi këtu t'ju kërkojmë llogari dhe t'ju vëmë përpara togës, por jemi këtu për të bashkëpunuar dhe për t'ju thënë se cilat janë rrugët për ta ngritur, duke evidentuar edhe të metat. I bashkohem shqetësimit të raportit të monitorimit. A i keni pasqyruar në format elektronik krahas procesverbaleve të gjitha mbledhjet, sepse mua më rezulton që mbledhja e fundit është me firmën e zotit Traja, i paraqitur si dokument një vendim i shkurtit i vitit 2021?

A është pasqyruar vendimi i emërimit të drejtorit të ri në faqen e Radiotelevizionit Shqiptar? Është absurde që dikush që nuk punon në RTSH ta hapë dhe nuk e ka vendimin. Madje, unë vetë kam kërkuar nëse kanë qenë të pasqyruar emrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar dhe nuk i kam gjetur në faqen *web* të RTSH-së.

Pse i thashë këto? A është punuar nga RTSH-ja për faqen *web*, sepse elementi i digjitalizimit është goxha fjalë e madhe? Faqja e RTSH-së është faqja më e dobët e çdo institucioni që unë kam ndeshur deri sot, për shkak të mospasqyrimin të të gjitha këtyre vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar.

Për Këshillin Drejtues kam këto pyetje. A janë zbatuar të gjitha kriteret që ju keni miratuar për emërimin e drejtorëve në sektorë të caktuar? E para.

E dyta, ka të bëjë me veprimtarinë e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. A duhet që Këshilli Drejtues të emëronte drejtuesin e tij, pasi të ishte plotësuar e gjithë trupa e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar?

E treta, a duhej të merreshin vendime me shumicë të cilësuar, ndërkohë që ju referuat që ka mungesa në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar? Kjo ka të bëjë me veprimtarinë reale dhe konkrete të Radiotelevizionit.

Sa i takon pjesës tjetër, pyetjet i kam jo për ju, por për të gjithë. Më është dërguar një relativitet ku pretendohet, këtë e kam për pjesën politike, që përfaqësimi politik në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar nuk është i balancuar. Sot jemi përballë dy vendeve, një nga PD-ja

dhe një nga PS-ja, jo fare, por këto duhen riparë, sepse përfaqësuesit e zgjedhur janë zgjedhur në një moment jo të përshtatshëm politik dhe përfaqësimet aty janë konfliktuale. Aty ka njerëz që kanë konflikt interesi, madje unë kam emrat, m'i kanë listuar, por do të quhen përgojime dhe nuk dua të bëhen lajme me emra të tillë, madje ka edhe njerëz që kryejnë edhe punë brenda Radiotelevizionit Shqiptar nëpërmjet formave dhe mënyrave të ndryshme alternative, gjë, e cila nuk duhet të jetë, sepse krijon konflikt interesi me Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

A mendoni ju që puna e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, ju thatë që nuk është një funksion i mirë, sepse konkurrohet shumë nga ekzekutivi, nga drejtori, është në staturen e duhur që duhej të kishte? Çfarë ka bërë ky Këshill për rritjen e cilësisë së Radiotelevizionit Shqiptar me vendimet e tij?

Unë e kam lexuar ligjin e medias dhe ai është perfekt në mënyrën si alternon drejtimi nga drejtimi ekzekutiv dhe raportin që ky drejtim ka me Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Kam qenë debutues i ligjit që nga viti 2013 dhe e njoh mirë ligjin, në mënyrë shteruese jo, dhe i di këto raporte. Unë e di shumë mirë që roli i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar është themelor në mbarëvajtjen e institucionit, sepse ka rol vendimmarrës dhe mbikëqyrës të rëndësishëm. Vetë fakti që ju bëni raportin do të thotë që po të doni, në raport e gozhdoni drejtorin, drejtoritë me radhë për punën e tyre të dobët përpara komisionit tonë, sepse ju e miratoni me votë dhe na e sillni ne këtu. Pra, duhet parë pikërisht kjo që ju thashë që në fillim se ku çalon puna në mënyrën e organizimit të KDRTSH-së.

Pa i marrë të drejtën...

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, duhen shënuar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Po ne që nuk kemi as sekretare dhe asnjë gjë, si ia bëjmë?

Leka Bungo – Ju mbani më shumë mend.

Luçiano Boçi - Jo, e pashë që e kishit seriozisht, por dua t'u lë vend kolegëve.

Leka Bungo – Kjo e fundit është kryesorja...

Petro Koçi – Një sekondë, ju lutem!

Ideja është që pavarësisht emocionaliteteve politike që ne kemi me njëri-tjetrin, ju nuk duhet të impaktoheni, por të përgjigjeni teknikisht.

Fjalën e keni ju, zoti Bungo.

Leka Bungo – Pyetja e parë kishte të bënte me performancën e Këshillit Drejtues gjatë kësaj periudhe, nëse është bërë e plotë dhe ajo që duhej. Unë ju them “jo” dhe një nga defektet kryesore jam unë. E para.

E dyta, dua t’ju them që sapo të dal nga kjo sallë, këtej e prapa nuk do të më shpëtojë asnjë gjë nga ato që the.

E fundit, por më kryesorja, dua t’ju bëj një pyetje. A ke forcë ti që ta detyrosh Belinda Ballukun, meqë je në Kuvend, për të mos e bërë atë rrugën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë jam si Haxhi Lleshi, apo jo?

Luçiano Boçi – Jo, nuk është kështu, sepse ti nuk je si Haxhi Lleshi, por je parlamenti i Radiotelevizionit Shqiptar, çka do të thotë që ti kontrollon, monitoron dhe merr vendime të rëndësishme. Drejtori është si qeveria, sepse zgjidhet dhe miratohet nga ju, jo si Haxhi Lleshi, sepse na çove...

Leka Bungo – Pse nuk ia mblidhni Edi Ramës?

Luçiano Boçi – E di pse nuk ia mbledhim Edi Ramës? Sepse nuk e lejon Lindita Nikolla.

Petro Koçi – Se nuk është me PD-në.

Luçiano Boçi – A e dini pse? Sepse këta kanë forcën e kartonit, të shumicës, kurse Radiotelevizioni Shqiptar, zoti Bungo, ka balancë politike. Për këtë arsye duhet balanca politike dhe qëllimisht ligji për median e parashikonte një gjë të tillë, por nuk është faji yt, por i pjesës së majtë. Pra, nëse do të ishte ajo balancë parlamentare, me kompetencat që ka KDRTSH-ja, sot do ta vinte me shpatulla pas muri drejtimin e RTSH-së, sepse kriteret i përcaktoni ju, emërimin e drejtorit e bëni ju, shkarkimin e drejtorit e bëni po ju. Ju pyesni: a e shkarkojmë dot? Po, e shkarkoni, sepse e keni në tagrin tuaj si KDRTSH, kurse ne nuk e kemi në tagrin tonë, sepse kërkojmë mocion mosbesimi, por nuk na lënë këta me votat. Unë duhet të manipuloj Ajazin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë të bëhemi bashkë dhe t’i themi anës politike: balanconi politikisht KDRTSH-në. Këtu ngrijeni zërin dhe unë do t’ju dëgjoj me shumë vëmendje.

Faleminderit!

Leka Bungo – Unë atje nuk kam shkuar në emër të partisë, unë jam Leka Bungo.

Unë nuk merrem fare me këto punë, por po ju them se gjëja kryesore atje është balancimi politik dhe kjo është një arritje e jashtëzakonshme. Nëse nuk e vlerësoni këtë, kjo është puna juaj, por ky është vlerësimi im profesional.

Personalisht, po të doni mos e besoni, e kam monitoruar me saktësi. Problemi im është, për fat të keq jam gabimisht edhe artist, se dua që ky televizion, përveç kësaj që është kolona kryesore, sepse është institucion mediatik dhe jo artistik, primare pas informacionit të ketë projektet artistike. Ne aty nuk jemi.

A e kupton që ligjet janë të Adil Çarçanit, apo nuk e kupton?

Unë sot paguaj dikë me honoraret që i ka paguar Adil Çarçani. Vjen dikush për të bërë një film dhe i thuhet që skenari bën 400 mijë lekë të vjetra, ndërkohë që 400 mijë lekë të vjetra kamerieri te hotel “Dajti” i merr bakshish në muaj.

Nuk ka mekanizëm, kështu që bëjeni mekanizmin dhe na krijoni liri, na jepni mundësi që ta paguaj Vera Grabockën 3 milionë dhe Leka Bungon 800 mijë, por nuk e kam unë këtë të drejtë. Unë kam të drejtën që një palo drejtor, jo ky, një tjetër, më thotë: “Ti je gazetar i mirë, por unë nuk të paguaj dot, kështu që do të jap vetëm 400 mijë”. Unë i them: “Po si i bëhet? Më shëno edhe si skenarist”. Ai më thotë: “Po të shënoj edhe si skenarist, po të jap edhe 400 mijë”.

Pra, në këtë mënyrë bëhen gjëra të asaj natyre që askush nuk do t’i bëjë. Ky është konflikt i madh, duket si anekdotë, por atje është dramë, më besoni. Unë kam minimumi 56 vjet që jam bashkëpunëtor i asaj ndërtese, i mirë apo i keq, kam punuar gjithë këto vite, prandaj më dhimbset. Kam edhe Mevlanin këtu, i cili tërë jetën e tij e ka lidhur me atë ndërtesë. Neve na dhimbset, jo se të tjerëve nuk u dhimbset, por jo aq as mua, pasi mua më dhimbset edhe emocionalisht, por këta nuk i përdorin emocionet, por përdorin tabelë shumëzimi.

Ne jemi emocionalë dhe na vjen keq që nuk jemi në gjendje të bëjmë një program më të mirë se “Portokallia”, ndërkohë që për 30 vjet e kemi bërë edhe më të mirë; e kam bërë unë me shokët e mi. Na e zgjidhni këtë çështje, duke na dhënë paratë.

Luçiano Boçi – Kam një ndërhyrje për çështjen e ligjeve, sepse u përmend jo ligji i Adil Çarçanit e jo i Haxhi Lleshit.

Ligji për median është bërë në vitin 2013 dhe mënyra se si funksionon...

Leka Bungo – E kisha për pagesat.

Luçiano Boçi – Për pagesat ka tavane buxhetore dhe je i saktë. Tavanet buxhetore përcaktohen nga politikat buxhetore të qeverisë, ku paga më e lartë ka disa tavane. Ju keni të

drejtën, duhet gjetur zgjidhje me mbështetjen tonë, sepse ne duhet t'ju japim mbështetje jo vetëm ligjore, por edhe financiare, që në Rregulloren dhe Statutin e RTSH-së në përputhje me ligjet “Për mediat” dhe “Për buxetin e shtetit”, të lëvizni tavanet buxhetore në raste honorarësh, vlerësimesh, programacionesh specifike dhe të caktuara. Kjo bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, që ju keni, me komisionin tonë dhe ne i çojmë si propozime pastaj te qeveria.

Unë këtë po ju stimuloj, që të mos arrijmë te pjesa që bëhet një raportim dhe ne kemi qejf t'ju shajmë se jemi opozita, por nuk është kështu, sepse ne jemi bashkëpunëtorë të Radiotelevizionit Publik Shqiptar. A kemi konsiderata politike? Po kemi, sepse i kemi shprehur publikisht që nuk jemi dakord me këtë, atë dhe atë, por sot jemi për të ndërtuar një bashkëmarrëdhënie dhe për t'ju stimuluar.

Zoti Bungo, a e dini se çfarë ndodh? Vini ju këtu për buxhetin, ai miratohet, sepse dihet urdhri, por nuk merrni fare lekë. Vini këtu dhe kërkon lekë, por ne nuk mund t'ju japim, sepse dihet, nuk është momenti për t'ju dhënë lekë. Kjo situatë është përsëritur vit pas viti dhe sot rezulton që ju jeni në balancën që atë që merrni e shpenzoni dhe nuk investoni dot.

Me aq sa unë kam dijeni, më parë, për diskutimet e rrjeteve frekuencore ishte përcaktuar që fituesi i tenderit për ndërtimin e rrjeteve frekuencore do të merrej me mirëmbajtjen për një periudhë 10-vjeçare, nuk do ta paguan Radiotelevizioni apo shteti shqiptar. Unë mendoj që kontrata të rishihet, shteti shqiptar e paguan të gjithë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo RTSH-ja, sepse RTSH-ja është ent publik, që ka një lloj pavarësie juridike. Nëse themi “e mirëmban shteti”, buxheti i shtetit duhet të pagujë. Në kontratën e parë, e cila u prish nga ministrja e Inovacionit, ishte parashikuar që kompania për 10 vjet do të mirëmbante rrjetet frekuencore në bazë të paketës financiare që mori, madje këtë e kemi debatuar në këtë komision. U ndryshua si u ndryshua, e ka shteti, shteti është shtet dhe nuk është Radiotelevizioni. Ta mbaj, ju bëni kërkesën dhe ne t'ju mbështesim dhe të vazhdoni aktivitetin, sepse kështu ne nuk do të bëjmë asnjëherë radiotelevizion publik, pa para nuk bëhet, por do të merremi me njëri-tjetrin.

Faleminderit!

Petro Koçi – Duhet të vijojmë normalisht, pasi deri tani është bërë si debat informal.

Sigurisht që Radiotelevizioni Shqiptar është interes publik, ndërkohë ka mjaft interesa private që e pengojnë zhvillimin e këtij interesi publik, sidomos sa u përket programacioneve artistike, kjo nuk ka diskutim. Unë besoj se një nga zgjidhjet është rritja e buxhetit apo ndryshimi

i aplikimit të mekanizmave financiarë, patjetër edhe miradministrimi, sepse për shkak të kontrolleve të KLSH-së dhe të disa pasojave, duket që ka pasur probleme në miradministrim. Gjithsesi, komisioni ynë e mbështet mbarëvajtjen e Radiotelevizionit Shqiptar, i cili ka nevojë për një ndryshim thelbësor, ndoshta edhe në politikat e buxhetimit apo të mbështetjes financiare, por e rëndësishme është që ka arritje.

Mua më vjen mirë që pavarësisht pozicioneve politike, kjo konfirmohet nga ky komision, siç është procesi i digjitalizimit, një arritje e jashtëzakonshme dhe që besoj që e ka rritur, ndoshta jo aq shumë sa pretendohej, shikueshmërinë e kanaleve të Radiotelevizionit Shqiptar. Nga ana tjetër është edhe çështja e balancimit politik në programacionet informative, por edhe kjo është diçka pozitive.

Zoti Madhi, keni nevojë për ndërhyrje?

Pandi Madhi – Për një sqarim teknik.

Petro Koçi – Po, zoti Madhi.

Pandi Madhi – Unë e përmenda edhe më parë kur prezantova shkurtimisht rezultatet për vitin 2021. RTSH-ja detyrohet të paguajë çdo vit për kontratën e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit 280 milionë lekë të reja në vit, plus, minus 5 milionë, në varësi të kursit të këmbimit të euros me lekut dhe buxheti i shtetit i jep vetëm 200 milionë. Që këtu krijohet një diferencë, të cilën duhet ta paguajë buxheti i shtetit për arsye se është detyrim, RTSH-ja duhet të paguajë edhe këstin e kredisë, por edhe 1/3 e mirëmbajtjes. Kjo është e vërteta.

Faleminderit!

Fjalën e ka zonjusha Ulliri.

Më pas zonja Zhupa.

Andia Ulliri – Faleminderit, zoti Koçi!

Së pari, dua ta theksoj edhe një herë pyetjen e parë të zotit Boçi, i cili kërkoi nga RTSH-ja kriteret e zgjedhjes ose të përzgjedhjes së drejtorëve dhe të anëtarëve, pra të personelit që punësohet. Në dijeninë tonë ligji parashikon që për rekrutimin e personelit duhet të ngrihet një komision i posaçëm *ad hoc* dhe shpallja duhet të bëhet në faqen zyrtare. Opozita ka dijeni që në dhjetor janë punësuar 4 drejtorë dhe procedurat e shpalljes janë bërë vetëm së fundi. Këta drejtorë kanë 5 muaj ose më shumë që firmosin si të tillë, pra janë të punësuar fiktivisht.

Ne si opozitë duam të vihemi në dijeni për procedurat e ndjekura nëpërmjet disa shkresave zyrtare. Cilat janë procedurat që ju keni pasur për shpalljen e vendeve të punësimit? Kush janë

saktësisht personat që janë punësuar? Informacionet për komisionet dhe procedurat e ndjekura për ngritjen e komisionit të posaçëm? Në fund të ditës RTSH-ja është pronë publike dhe duhet të trajtohet si e tillë për interesin e qytetarëve dhe të publikut. Mungesa e transparencës për mospërfshirjen e këtyre informacioneve, plus raporteve të tjera të cilësuar edhe nga nënkryetari i këtij komisioni janë të patolerueshme, prandaj ky informacion duhet të vihet në dispozicion të komisionit sa më parë.

Pyetjet e mia janë: cilat janë procedurat e shpalljeve? Kush janë këta persona? A janë punësuar fiktivisht? A është ngritur komisioni? Si e gjykoni ju këtë çështje? A jeni si të tillë në konflikt me ligjin?

Po kaloj në çështjen tjetër. Në relacionin e mëparshëm u përmend edhe “RTSH shkolla”. Gjatë periudhës së Covid-it në të vërtetë “RTSH shkolla” mund të quhej më shumë si dështim sesa sukses, për faktin e vetëm që rrjeti nuk është i shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha familjet shqiptare. Nuk mund të them që ka pasur monitorim të prindërve për shumë nga programacionet, por ka pasur edhe problematika nga më të ndryshmet, pavarësisht se RTSH-ja është përpjekur të bëjë më të mirën, duke u nisur edhe nga situata që kishit.

Si e tillë është cilësuar: “Kanali i ri televiziv është projektuar si alternativë e mësimin në distancë për t’u dhënë nxënësve një mënyrë tjetër të nxënies së kurrikulës mësimore me anë të ekranit TV, kompjuter, tabletë, telefon e të tjera”. “RTSH shkolla” që nga mënyra si u konceptua dhe u transmetua ishte një program thjesht formal, prandaj opozita e ka ngritur shumë herë këtë çështje, gjë që tregon se nuk ishte aspak ndërveprues si në minuta, ashtu edhe në temat mësimore, të cilat nuk kishin asnjë përfitim për nxënësit.

Marrja e mësimave përmes telefonit nuk është parë në asnjë vend dhe nuk ka pasur asnjë rast ku të thuhet se është rritur në mënyrë eksponenciale mundësia e marrjes së mësimin nga nxënësit. Kjo fjali është marrë nga raporti që ju keni sjellë në Kuvend.

Kjo mund të jetë një mënyrë alternative, pra nuk është një metodë frytdhënëse, në gjykimin tonë, por besoj edhe në gjykimin e pjesës më të madhe të familjeve shqiptare, dhe nuk mund të provohet si e tillë. Pyetja që unë kam është: a keni ndonjë anketim, pyetësor apo studim që ka vërejtur efektet e larta, siç keni pretenduar në raportin tuaj mbi këtë mënyrë mësimdhënieje? A ka paguar ndonjë tarifë të veçantë Ministria e Arsimit për programin “Auditorium” apo kanalën “RTSH shkollë”?

Këto ishin ato që unë kisha për relacionin e zotit Ajazi, por edhe për raportin që ju keni dhënë. Unë mendoj se këto janë disa nga çështjet që duhen trajtuar, pavarësisht se tani mësimi ka filluar dhe vijon normalisht, por mendoj që ka pasur një mungesë totale në menaxhim ndoshta nga qeveria dhe nuk ka qenë aspak efiçente, siç ju e keni cilësuar. Dua të di: a keni pasur ju një pyetësor apo anketim që vërteton efektet e larta që ju pretendoni?

Dua të vë disa pika mbi “i”, siç e tha edhe zoti Boçi, pasi në të vërtetë e gjithë KDRTSH-ja ka një pabalancë të theksuar. Në vija politike në ato momente ne nuk kemi qenë pjesëmarrës në proces, kështu që mendoj se ky është një proces tërësisht antiligjor.

Neni 94 i ligjit nr. 97/2013, pika 4/b përcakton se: “Në çdo rast komisioni mban parasysh ruajtjen e balancës, duke pasur 5 kandidatë të mbështetur nga maxhoranca dhe 5 kandidatë të mbështetur nga opozita dhe këta kandidatë i propozohen për miratim seancës plenare.”

Këtu dua të vë pikat mbi “i” dhe t’ju them se pavarësisht punës që është bërë, KDRTSH-ja ka një mungesë të balancës politike ndoshta edhe të balancës në vendimmarrje.

Duke ju falënderuar, pres përgjigjen tuaj për pyetjet që ju bëra, patjetër edhe të çështjes së drejtorëve që janë punësuar në konflikt me ligjin!

Petro Koçi – Zoti Bungo, keni ndonjë përgjigje?

Leka Bungo – Janë disa probleme për të cilat e kam të vështirë të përgjigjem, siç është çështja e emërimeve, një çështje që nuk është në kompetencën time dhe unë nuk mund t’ju jap një opinion. Konkretisht, nuk mund t’ju them se do ta zgjidh, por nesër mund t’ju them më shumë gjëra, sepse nuk jam i përgatitur për këtë dhe për t’ju thënë një gjë konkrete, sipas pyetjes që bëni ju. Ju keni të drejtë të pyesni për këtë.

Ndërsa për sa i përket çështjes së balancës, që ju thoni për Këshillin Drejtues, ajo është një çështje tjetër dhe ju e keni shumë të vështirë të na thoni se kush është i PS-së dhe kush është i PD-së. A mund t’i gjeni dot? Nuk i gjeni dot. Aty është bërë një lëmsh që s’ka burrë nëne që ta zgjidhë. Unë nuk i kuptoj. Unë nuk kuptoj se kush më kundërshton dhe kush jo. Po kush merr vesh kështu si jeni bërë ju?! Ka burrë nëne t’ju kapë ju?

Petro Koçi – Zoti Bungo, lejohet deri te fjala “kashtë” jo më tej.

Leka Bungo – Ju keni të drejtën tuaj dhe unë mendoj se ajo mund të hetohet nga ana juaj. Kush do ta hetojë? Ne do ta hetojmë? Unë do ta hetoj? Ato tallen!

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë jam për tjetër gjë. Nuk jam unë për këtë. Ju i keni balancat. Ju zgjidheni. Vendimet i merrni ju, nuk i marrim ne.

Petro Koçi – Nuk e vendos zoti Bungo përbërjen e Këshillit Drejtues të RTSH-së.

(Diskutime pa mikrofon.)

Urdhëroni, zoti drejtor!

Enkelejd Joti – Lidhur me pyetjen e zonjës në lidhje me kriteret që vendosen për përzgjedhjen e punonjësve, nuk ka rëndësi nëse janë në nivel drejtues apo punonjës të thjeshtë. Aktualisht, të gjitha vendet vakante janë shpallur qoftë në televizion, në medien tonë, qoftë edhe në uebsajtin tonë. I kemi bërë me dije të gjithë të interesuarit që kriteret dhe detajet t'i shohin te faqja e internetit. Kjo për sa i përket pjesës aktuale.

Lidhur me rekrutimin e punonjësve, theksoj se nuk është drejtori i përgjithshëm i cili ka një harem aty dhe merr punonjësit si të mendojë ai. Ka një drejtor të burimeve njerëzore, e cila ka për detyrë të përzgjedhë, duke marrë në konsideratë edhe kriteret, personat që i plotësojnë këto kritere, duke pasur parasysh vendet vakante, nevojat që kanë drejtoritë përkatëse dhe specifikat që mund të ketë ai pozicion pune.

Sot ne jemi duke bërë një ristrukturim të RTSH-së me idenë për ata punonjës, që aktualisht punojnë aty, që janë më rentabël, më frytdhënës se sa kanë qenë më përpara, kjo, në këndvështrimin tonë, për të pasur një efikasitet të këtyre punonjësve, sepse ka njerëz që kanë mbingarkesë dhe ka disa njerëz që, në këndvështrimin tonë, nuk kanë ngarkesën e duhur.

Për të pasur një shfrytëzim të mirë të aftësive të tyre është menduar të bëhet ky ristrukturim. Kjo për sa i përket punësimit.

Ndërsa për sa i përket pjesës së “RTSH-shkollë”, që ju thatë, në dijeninë time, nga të gjithë qytetarët, dhe unë e kam parë si qytetar kur është vendosur, se nuk kam qenë pjesë e RTSH-së, ka qenë një sukses dhe gjetje fantastike dhe, me sa kam dëgjuar, mbase edhe për humor, kanë mësuar jo vetëm nxënësit, por kanë mësuar edhe mësuesit nga ajo mësimdhënie.

Në dijeninë time, se kemi pasur diskutime me Ministrinë e Arsimit për vijimin e këtij projekti, aty janë zgjedhur, sipas Ministrisë së Arsimit, se ata e kanë bërë përmbajtjen dhe lëndët që do të jepeshin, është bërë përzgjedhja e mësuesve më të mirë për të pasur rezultate më të mira.

Në dijeninë time, duhet të ketë rreth 25 fëmijë që bëjnë mësim kolektiv në Shqipëri dhe, sipas Ministrisë së Arsimit, është i domosdoshëm vijimi i një pjese të këtyre programeve, për të cilat ne jemi duke diskutuar, kemi ngritur edhe një grup pune që të ketë edhe një program ku

familjarët apo fëmijët ta dinë kur janë oraret e mësimit të historisë, të gjeografisë dhe të tjera me radhë. Kjo është sa na përket ne, ndërsa përmbajtja nuk është detyra jonë, nuk është misioni ynë, por i Ministrisë së Arsimit që e ka detyrë funksionale.

Petro Koçi – Faleminderit!

Duhet të kuptojmë një gjë që qoftë “RTSH-shkolla”, qoftë mësimi *online* ishin vetëm mënyra alternative për të zëvendësuar atë që, në fakt, është i pazëvendësueshëm, mësimi në klasë.

Është i suksesshëm relativisht, sepse, në përputhje me situatën, sigurisht që ishte një gjë e suksesshme. Nuk është se e zëvendëson mësimin në klasë. Pa dyshim që ka një diferencë mes mësimit që jepet nga televizori dhe mësimit të drejtpërdrejtë mes mësuesit dhe nxënësit.

Lidhur me performancën e punonjësve, mendoj se në përgjithësi në administratën shqiptare mungon sistemi i matjes së performancës dhe do ta sugjeroja se, në rast se kjo do të arrihet në RTSH, do të jetë një gjë shumë e mirë. Pra, të bëhet e matshme puna e secilit dhe e raportueshme. Kjo është zgjidhja, por ne në përgjithësi na mungon kjo gjë në kulturën tonë administrative.

Urdhëroni, zoti Shanaj!

Mevlan Shanaj – Së pari, ju falënderoj!

Meqenëse ndodhem këtu, i pamësuar me formate të tilla, doja të shprehja një të vërtetë shumë të madhe. Duke ju respektuar, duhet të dini se unë në atë institucion kam vajtur në '68-ën dhe e di historinë e dhimbshme dhe të tmerrshme të dhunimit politik që u bëhej shqiptarëve nëpërmjet atij institucioni. Unë i përkisja artit, por jetoja aty. Sot është fitorja më e madhe. Në parlament, jo se jo, por në asnjë media tjetër nuk ka pavarësi politike siç ka në RTSH.

Unë nuk punoj atje, vitet e fundit isha profesor dhe jam në pension, por vij me mallin, dhimbjen dhe shqetësimin për shtëpinë time të dytë. Më shumë më merrte kohë televizioni sesa familja. Kështu që të jeni të qartë, pa asnjë aludim, asnjë prapamendim, që nuk ka në Shqipëri vend më të sigurt, ku politika nuk ka influencë fare. Kjo ndodh në Televizionin shqiptar. Nuk e bëjnë dot televizionet e tjera, sepse ata marrin tendera; ata i shërbejnë, i servilosen atij që është në krye të qeverisë. Tani rastis që është Rama, pardje ishte ai tjetri, pastaj do të vijë një tjetër. RTSH-ja i ka përcaktuar dhe njerëzit kanë shpëtuar nga ky detyrim, se nuk të heq njeri nga puna për pasione politike.

Thashethemet, zoti Koçi, ose Boçi, ose tjetri, që përmendët për Këshillin Drejtues, i keni kot. Unë nuk flas nga pozitat e politikanit, por flas nga pozitat e Mevlanit. Nuk ka absolutisht

ndikim asnjë lloj politike; absolutisht, nuk ka si të ketë. Unë në natyrë jam rebel, se i përkas artist, në jetë jam korrekt, por nuk jam për nënshtrim administrativ.

Nuk e mora fjalën që të bëja këtë prezantim, por e mora që t'ju them ju, që keni mundësi të përmirësoni mundësinë e shtimit të buxhetit. Televizioni Shqiptar nuk i konkurren dot mediet e tjera, sepse nuk e ka atë mundësi financiare. Të vetmen traditë të fuqishme ne kishim programet artistike. Ne bënim filma. Janë bërë filma, po filloj nga vetja, si Beluli, "Plumba Perandorit" apo "Udha e shkronjave". Ne kishim këtë traditë: një herë në javë teatër, kishim javë për javë humorin, varietenë etj., dhe me këto ishim dominues. Tani në art ne, si televizion, nuk kemi asgjë, prandaj askush nuk e kthen, por arti nuk bëhet pa para dhe artist nuk bëhesh dot me mik, le të vijë cilido nga ju. Ja, për shembull, sot po themi që Edi Rama ka qejf ta bëjë djalin e tij artist, aktor. Nuk e bën dot. Pra, ekrani dhe fusha e sportit nuk bëhen me mik, miqtë e mi. Kam 54 vjet që merrem me këtë punë. Kjo bëhet në sajë të performancës individuale, talentit, mundësisë.

E kishte Halili djalin tek Tirana, e hoqi. Halili, ai i ka paratë. Pra, që të bëhet art në televizion, ju këtu keni mundësi të promovoni.

Unë po jap nja dy mendime alternative. Diku në botë vendosën që për ta ndihmuar kulturën për dy vjet thanë: helmin kulturës. Hoqën doganën e cigareve dhe të alkoolit për t'ia kaluar kulturës. Nuk e bën dot Shqipëria, se thotë janë pare e madhe. Dakord.

Diku tjetër në botë, në Zvicër konkretisht, morën iniciativën që kaq për qind, punë ekspertësh, të kalojë për filmat që ta mbajmë në këmbë filmin; kjo ishte një ide. Ne nuk ua bëjmë dot bankave, sepse edhe ju njerëz të zakonshëm jeni, që të vendoset ky ligj me këto banka, të cilat janë më shumë se oligarkë, sipas medies, se unë nuk merrem me këtë punë, por ju mund t'u thoni: kaq për qind nga biznesi juaj, nga transaksionet tuaja, do t'ia kaloni kulturës, do t'ia kaloni artit. Këtë mund të vendosni ju me ligj.

Ju mund të bëni një gjë tjetër, dhe është krejtësisht e mundur. Të gjitha mediet private shfrytëzojnë krijimtarinë tonë artistike dhe ju mund t'u thoni që nuk do t'i gjobisni për këtë gjë, por nga reklamat, se ato janë zotë të reklamave, Televizioni Shqiptar nuk ka reklama fare, ose shumë pak mund të ketë, se ato marrin reklama të qeverisë, kryesisht dhe jo vetëm të oligarkëve, pra ju mund ta vini në ligj që mediet private, të cilat shfrytëzojnë artin dhe kulturën e Televizionit Publik Shqiptar, nga reklamat që marrin, sepse ata janë disponues të reklamave, 1% të të ardhurave t'ia kalojnë zhvillimit dhe mbrojtjes së artit në Shqipëri.

Ka shembuj të tjerë, këto që po them, janë të mundura. Në vende të tjera ka shembuj sa të duash, i thotë do të paguash për teatrin mbretëror dhe teatrin e operës 1% të të ardhurave, siç themi ne për RTSH-në. Ka qytetarë, po themi nga ekstremi, nga Konispoli që s'do të vijnë kurrë tek Teatri i Operës, por thotë që, në rast se ti nuk paguan para, kjo opera degradon për show për të mbijetuar. Pra, shteti, kur nuk i ka mundësitë ekonomike, gjen alternativa.

Unë tani ju propozova juve 2-3 alternativa, në rast se isha i saktë në këto që thashë, për të zhvilluar ekranin artistik, ndryshe ai televizion absolutisht nuk ka për ta tërhequr vëmendjen e shikuesve, sepse televizionet private janë të fuqishme me të ardhurat që ata i dinë se nga i sigurojnë. Televizioni Shqiptar nuk siguron dot të ardhura, përveç buxhetit që aprovoni ju.

Faleminderit për vëmendjen!

Kërkoj ndjesë!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Shanaj!

Sigurisht që ne jemi të vëmendshëm ndaj nevojave që ka RTSH-ja për të rritur buxhetin. Sigurisht që sugjerimet janë një pjesë e rëndësishme, por kjo është mbledhje, ku raportohet për veprimtarinë e vitit 2021, pra ky është objekti i kësaj mbledhjeje, por ne e shfrytëzojmë edhe për të hedhur ide e alternativa për ta përmirësuar punën, sepse në mbledhjen tjetër ose ndoshta pas dy mbledhjesh, se varet sa mund të zgjasë procesi, kur të diskutojmë për rezolutën, do t'i përfshijmë mundësisht edhe këto lloj idesh që janë të domosdoshme për t'u marrë parasysh dhe për t'u marrë në konsideratë.

Lindita Buxheli – U kërkoj kolegëve të jemi më koncizë, më të koncentruar, sepse radhën tjetër u bënë aq shumë pyetje dhe u zgjatëm aq shumë tek të parët, sa nga fundi nuk mundëm të shprehnim ato pyetjet që vërtet na shqetësojnë për komunitetet nga vijmë.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj!

Petro Koçi – Urdhëroni, zonja Zhupa!

Ina Zhupa – Faleminderit, i nderuar drejtues!

Në fakt, duke dëgjuar deri tani pjesën e raportimeve, dua të them se, si zoti Bungo, si zoti Shanaj kanë të drejtë kur flasin për mungesë buxheti, por besoj se janë të qartë që këtu mungon vullneti politik për t'i çuar paratë në drejtim të televizionit, në drejtim të artit, kulturës, por mungon vullneti politik, në fakt, për t'i çuar paratë në drejtim të qytetarëve në përgjithësi.

Imagjinoni sikur 430 milionë euro, 10% e këtyre, shumë që harxhohet për gjeneratorët që nuk djegin, t'ia jepnin RTSH-së!

Pra, shteti shqiptar ka para, thjesht nuk ka vullnetin që këto para të çohen në drejtimin qoftë të RTSH-së, meqë e kemi sot temë, por qoftë edhe në drejtimin e arsimit që ne e kemi debatuar, të kulturës në përgjithësi.

Kështu që ne, si deputetë të opozitës, kemi bërë gjithmonë betejë në këtë aspekt, edhe në buxhetin që kaluam, por forca e kartonit është mbi forcën e logjikës në Kuvend, kështu që ata kanë arritur ta kalojnë gjithmonë si kanë dashur, se kanë 74 vota.

Për sa i përket asaj që ngritën edhe kolegët, legjitimitetit të Këshillit Drejtues të RTSH-së, është një çështje, po ashtu, politike që nuk ka lidhje me personat që janë aty, sepse jemi ne, ka qenë ky komision, ka qenë parlamenti, i cili duhej t'i kishte zbatuar rregullat për emërimin e anëtarëve të Këshillit të RTSH-së. Nuk janë ata që emërojnë veten e tyre, as i emërojnë kolegët e tyre, as zgjedhin që ta kenë apo jo anëtarin zëvendësues, por jemi ne, është politika, është qeveria, është parlamenti, në këtë rast qeveria, sepse ju jep juve vullnetin për të votuar, se ju e merrni viston nga ata.

Sigurisht, janë shkelur të gjitha rregullat, sepse ka anëtarë të Këshillit Drejtues që, sipas Rregullores, duhej që minimalisht të kishin 3 vjet që duhej të ishin larguar nga RTSH-ja, që të zgjidheshin në Këshillin Drejtues, dhe nuk ka. Nuk po merrem me emra. Duhej të ishte zbatuar balanca e profesioneve dhe nuk është zbatuar, nuk po i hyj fare balancës politike, se ndoshta është ajo, që thotë edhe zoti Bungo, që s'i dihet ndonjëherë, se në mëngjes janë socialistë dhe në darkë demokratë. Nuk po i hyj asaj, po i hyj pjesës ligjore dhe propozimeve ligjore. Kjo për sa u përket debateve që u bënë deri tani.

Unë kam disa pyetje konkrete për drejtorin e RTSH-së.

1. Është një dyshim i arsyeshëm i njerëzve, që njohin aktivitetin tuaj dhe lidhjet tuaja edhe me televizione private në Shqipëri, kështu që pyetja ime e parë është: Për sa u përket të drejtave televizive që ka dhe fiton RTSH-ja, së pari, ju keni shumë pak kohë, kështu që nuk mund t'ju vë përgjegjësi për ato që janë bërë, në fakt, janë bërë dëme të mëdha, duke i blerë të drejtat dhe duke ua shitur subjekteve të tjera private, televizioneve të tjera private, ju si drejtor i ri i RTSH-së, a reflektoni se ka problematikë në marrjen e të drejtave televizive që merr RTSH-ja dhe transferimin e tyre te platforma të tjera me pagesë? Se i bie që qytetarët shqiptarë të paguajnë dy herë, se e paguajnë një herë RTSH-në që e blen dhe e paguajnë edhe një herë pastaj platformën X apo Y, s'po përmend emër, e cila e blen nga ju dhe ua shet përsëri qytetarëve shqiptarë.

2. A keni ju një plan që gjëra të tilla të mos ndodhin?

3. Në blerjen e të drejtave televizive, në këtë komision kemi gjykuar se ish-drejtorë të mëparshëm kanë bërë kontrata nga më skandalozet dhe shembujt na i ka sjellë vetë kryetari i Këshillit Drejtues, p.sh. kontrata ishte vetëm në anglisht dhe nuk e dinin fare se çfarë kishin firmosur. A do të vini ju disa standarde? Se do të vini prapë këtu dhe do t'ju pyesim, të paktën, minimalisht, po ju pyesim tani në fillim të detyrës suaj për të kuptuar se cilat do të jenë standardet tuaja në drejtim të blerjes së të drejtave televizive për ato që transmeton në mënyrë ekskluzive RTSH-ja, si shërbim publik që mbahet me fondet publike.

4. Në dijeninë time, emërimet në RTSH edhe gjatë drejtimin tuaj bëhen në një mënyrë shumë të çuditshme, në qoftë se mund ta quaj kështu. Emërohet një herë drejtori, bën 4-5 muaj punë dhe pastaj shpallet vakanca për pozicionin e drejtorit që do ta marrë drejtori që është bërë drejtor aktualisht.

A është kjo normale dhe a do të jetë kjo një praktikë pune, apo duhet që kjo të ndryshojë, se është antiligjore dhe besoj se këtë e kuptoni, sepse ka raste kur drejtorët janë vendosur 4 muaj para dhe 10 ditë më parë ju keni shpallur vakancën? Thatë vetë që keni problematika me faqen *web*, mund të jetë edhe kjo e lidhur, por nuk besoj se shpalljet e vakancave dhe emërimet janë kaq të vështira për t'u hedhur në faqen *web*.

RTSH-ja ka, të paktën, 15 procese gjyqësore me individë, të cilat janë të pushuar nga puna, të cilët kërkojnë të drejtën e tyre. Ku është RTSH-ja në këto procese gjyqësore? A është duke i fituar apo duke i humbur, siç është në traditën e vet më të mirë dhe paguhen dy herë punonjës, ata që kemi pushuar me të padrejtë nga puna dhe ata që kemi marrë në punë për të zëvendësuar ata që i kemi pushuar?

Ju, si drejtor i ri i RTSH-së, do të ndiqni të njëjtën rrugë, siç kanë ndjekur drejtorët e mëparshëm në procesin e rekrutimeve dhe të pushimeve nga puna, thjesht si preferenca momentale? Ndoshta këto janë paragjykime për shkak të asaj që ka ndodhur më parë, kështu që nuk dua të merrni si akuzë, sepse janë gjëra për t'u vërtetuar dhe thashë se do të vini përsëri këtu.

Ju e përmendët edhe raportin e KLSH-së. Një nga raportet e KLSH-së unë e kam këtu, por nuk dua të harxhoj kohë për t'ju lexuar. Flet për shkeljet financiare që bën RTSH-ja dhe për dëmet financiare në veprimtarinë e tij, këto të lidhura drejtpërdrejt me vendimmarrjen që kanë drejtorët përkatës ose drejtori i përgjithshëm i RTSH-së.

A do të merrni masa dhe a do ta keni ju si dokument pune raportin e KLSH-së dhe a keni filluar që tani, duke marrë masa në lidhje me ato që janë bërë dhe situatën që keni gjetur ju?

Më ka bërë përshtypje në raport lista e disa emisioneve që nuk i kisha dëgjuar kurrë, nuk e dija fare që kishte emisione të tilla dhe jam çuditur se sa shumë emisione kishte RTSH-ja që nuk njihen fare. Ndoshta nuk i njoh unë, por ndoshta i njohin të tjerët.

Pyetja ime është: a keni ju një matje audience të RTSH-së sipas emisioneve, programeve që transmetohen? Në matjen e kësaj audience, a e reflektoni ju këtë në vendimmarrjen që merrni për programet që duhet të vazhdojnë apo që nuk duhet të vazhdojnë, programet që duhen mbyllur ndoshta apo për programet e reja që ka nevojë? Ndoshta nuk do të jetë e nevojshme, sepse është mënyrë se si t'i menaxhosh paratë, ndoshta nuk është e nevojshme të bëni 12 emisione dhe të ndani 12 lloje pagash, por të bëni 2 emisione të mira, disa ritransmetime apo mënyra të tjera për ta mbushur 24-orëshin, por të paktën të jenë 2 të mira që kanë audiencë, paguhen mirë dhe ia vlen, por jo ta mbushim të gjithë ditën me emisione që nuk i shikon askush, sa për t'u paguar! Më çudit ky inflacion i programacionit që nuk prodhon vlera dhe shikueshmëri, sipas këndvështrimit tim. Ju do të më thoni pastaj nga matjet tuaja të audiencës...

Përpara jush ka raportuar këtu zoti Martin Leka, të paktën, sa kam qenë unë në këtë komision, ka folur për arkivin e RTSH-së dhe për procesin e digjitalizimit të arkivit të RTSH-së. Me sa pashë edhe nga raporti, nuk është një proces që konkludohet për një vit apo konkludohet shpejt. Dua të pyes edhe në lidhje me atë që ju, si drejtor i ri, keni si vizion në lidhje me këtë temë.

E fundit, sot gjendet në burg ish-drejtori i RTSH-së, Thoma Gëllçi për "RTSH Agro". Unë e shikoj "RTSH Agro", vazhdon e transmeton si kanal i RTSH-së. Pyetja ime e fundit, në kuadrin e një kurioziteti, sepse nuk e njoh dosjen hetimore të zotit Gëllçi, shkeljet që ishin bërë, që çuan në burgosjen e ish-drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, nuk sollën, të paktën një bllokim momental të atij televizionit për çështje provash, të asaj frekuence të RTSH "Agro", apo vazhdon dhe ato shkeljet nuk kishin lidhje me atë që transmetohet? Pra, dua të di situatën e vazhdimit të transmetimeve si televizion normal dhe, nga ana tjetër, arrestimin për shkelje të ish-drejtorit Gëllçi. Në këndvështrimin tuaj, sa e njihni situatën si drejtor i ri?

Petro Koçi – Zoti Joti, fjala për ju.

Enkelejd Joti – Besoj se të gjitha pyetjet ishin për mua.

Në fakt, pjesa dërmuese e pyetjeve tuaja kishin të bënin, ose do të them vetëm diçka, mund të kisha një pyetje: a do ta bësh t'i detyrën si drejtor i RTSH-së në vijim, apo jo?! Unë them që po. A do t'i respektoj unë detyrimet e mia ligjore ose përgjegjësitë e mia?! Unë do të them që po. Ju përmendët pak më përpara edhe arkivin. Unë fola, ndoshta, ju nuk ishit në atë moment, që

është një nga prioritete e mia dhe e kam si një gjë shumë të rëndësishme për ta realizuar këtë, pavarësisht se është folur prej vitesh edhe nga drejtori i mëparshëm. Në dijeni time, janë bërë përpjekje dhe do të doja që ta finalizoj, por ky finalizim, po ripërsëris ato që thashë pak më përpara, arrihet në momentin kur ka një vullnet. Ky arkiv nuk do të konsiderohet thjesht një arkiv i RTSH-së, por si një trashëgimi kulturore e shtetit shqiptar, sikundër shtete të tjera rajonale dhe jo vetëm. E kam konsideruar dhe kam vënë buxhete, këto janë procese që zgjasin edhe 10 vjet, në varësi të përmasave që ka arkiva. Ne kemi milionë metra film, sepse janë disa formate, që duhen digjitalizuar, duhen trajnuar njerëzit, duhen krijuar hapësirat e posaçme, për shkak se arkivat që kam parë unë, sidomos edhe pas problemeve me tërmetin nuk kanë qenë në gjendje të mira, jo vetëm arkiva, por i gjithë televizioni ka nevojë për një ristrukturim thelbësor, por të mos kalojmë tek ato, se nuk mbarojmë kurrë.

Ajo që dua të them, do t'i marr me radhë, në lidhje me të drejtat televizive nuk kam informacion që RTSH-ja, të paktën në këto momente, të ketë të drejta që t'i shesë diku tjetër. Nuk jam i informuar se çfarë është bërë më përpara që të jem i sigurtë.

Ju informoj se RTSH-ja, fatmirësisht, trashëgon një të drejtë televizive që është marrë nëpërmjet EBU-së dhe është Kampionati Botëror, i cili është në mes të nëntorit deri në mes të dhjetorit. Kjo e drejtë televizive do të transmetohet e gjitha në platformën e RTSH-së dhe nuk ka pasur as para meje, në dijeninë time, sepse jam informuar dhe as në vijim nuk ka asnjë bisedë, tratativë, asnjë opinion, asnjë mendim për këtë gjë. Natyrisht, unë si drejtor i Përgjithshëm, nëse do të kem, nuk është e thënë që në vijim, për interesin ekonomik të RTSH-së, por jo vetëm, nuk mund ta bëjmë një gjë. E konsideroj RTSH-së si televizion dhe, përveç detyrimeve që ka për të ushqyer publikun me informacione jokomerciale, se ne nuk jemi në këtë treg për të konkurruar direkt me televizionet private, sepse ne nuk mund të bëjmë çdolloj programi që bën një televizion privat, i cili mund të jetë një program komercial, neve nuk na takon edhe për etikë, ose për shumë detyrime të tjera, për misionin që kemi absolutisht. Në shumë nga programet që ne realizojmë, nuk kemi mision vetëm konkurrencën, kjo e fundit është e rëndësishme, por jo për konkurrencë të bëjmë gjëra që nuk na takojnë e të dalim jashtë misionit tonë. Ka raste që janë disa programe, siç është rasti i disa pakicave, që ne duhet t'u drejtohem që janë në minorancë, në raport me të tjerët, që mund të mos kenë interes, por kjo nuk na heq detyrimin për ta realizuar dhe për t'iu drejtuar këtij komuniteti. Kjo nuk duhet parë thjesht nga ana komerciale, ka apo nuk ka audiencë.

Lidhur me matjen e audiencës, nuk di që në Shqipëri të ketë një matës audience, i licencuar ose, më saktë, i pranuar, sepse gjithmonë, edhe nga eksperiencia ime e mëparshme në një televizion, ka pasur një shoqëri, një tjetër ka pasur një tjetër, dhe matjet e audiencës kanë dalë gjithmonë të pasakta. Ka pasur gjithmonë, me sa jam i informuar, tentativa nga AMA për të realizuar një matje audience që të njihet nga të gjitha televizionet. Nuk e di sa është e mundur të arrihet kjo gjë.

Lidhur me emërimet, pak më përpara zonja Ulliri bëri një pyetje. Unë iu përgjigja pikërisht për emërimet. Emërimet edhe për drejtor, si dhe çdo punonjës tjetër, nuk i bën drejtori i Përgjithshëm, por Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Nëse do t'u referohem këtyre pyetjeve që keni ju, unë e kam me kryetarin e Këshillit që këtë pyetje, që ma bëni gojarisht, e kam zyrtarisht, dhe po i kthejmë përgjigje zyrtare Këshillit që të informohet saktësisht se si janë marrë në punë këta drejtorë, që është hapur vendi vakant. Për informacion, vendet vakante, po marr rastin e Drejtorisë Juridike, meqenëse e përmendët, për shkak të situatës së mëparshme, nuk kemi pasur drejtor Juridik, ka qenë vendi vakant. Edhe drejtorin Juridik, edhe drejtorin e Prokurimeve sot me ristrukturim i kemi vendosur dy drejtori në një të përbashkët. Kemi bërë një ristrukturim, ku në faqen tonë të internetit kemi nxjerrë çdo detaj që duhet të plotësojnë aplikantët. Kemi bërë edhe publikimin në medie, në RTSH, jo vetëm në RTSH 1, RTSH 2, por në të gjitha kanalet, kemi bërë informimin e të gjithë të interesuarve, të cilët mund t'i shohin këto detaje në faqen tonë të internetit. Pjesë e ristrukturimit të RTSH-së është dhe interneti, të cilin e konsiderojmë si një medie shumë të rëndësishme për qytetarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, sikurse është televizioni, sikurse është radio, po ashtu është edhe interneti. Aktualisht, për informacion, ne kemi 4-5 fishuar numrin e punonjësve të faqes së internetit, e kemi bërë drejtori më vete.

Petro Koçi – Më falni për ndërhyrjen!

Zonja Zhupa e kishte idenë këtu që nganjëherë ndodh jo vetëm te ju, por në administratë që dikush komandohet dy-tre muaj dhe pastaj publikohet vendi dhe ai që është aty kuptohet që ka avantazhin. A ka ndodhur kjo praktikë? Më duket se kjo ishte pyetja konkrete.

Enkelejd Joti – Në fakt, nëse unë dikë e njoh, i njoh vlerat e këtij individi, është gjë e normale, por, fatkeqësisht, RTSH-ja nuk e ka luksin të qëmtojë në treg se cili është më i miri dhe t'i jap pagën, sa e mendoj unë, nuk e kam këtë luks. Në çdolloj fushe, në çdolloj specialiteti, është fat që ta njohësh një njeri dhe t'ia kuptosh vlerat dhe kontributin e tij, është dhe njerëzore, ndërkohë kjo nuk ka të bëjë me shijet apo gustot e drejtorit të RTSH-së, por ka të bëjë me të gjithë statutin

që jam përpjekur ta respektoj dhe mbaj përgjegjësi ligjore për këtë gjë, për çdo veprimi që bëj; nuk i shmangim përgjegjësitë. Në fund fare, kur firmosim, kemi detyrimet dhe përgjegjësitë që marrim përsipër, sikundër edhe raportin e KLSH-së që e kemi në konsideratë dhe është një nga Biblat që kemi për vijimin e punës. E kemi ngritur grupin e punës, sepse kemi detyrime ndaj KLSH-së për t'i raportuar në një periudhë kohore të caktuar.

Cilat janë masat që kemi marrë, pasi ata kanë dhënë rekomandime? Ne i zbatojmë nëse i çmojmë si të rëndësishme, ose nuk i zbatojmë, në fakt nuk ka ndodhur ndonjëherë që të mos i zbatojmë, nga eksperiencia ime në një institucion publik.

Për “RTSH Agro” nuk kam informacion lidhur me arsyen. Për ish-drejtorin, në dijeninë time, nuk është shpallur ende vendimi, megjithatë nuk jam shumë i saktë. Me sa di unë, është në hetim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky nuk është problemi im.

Ina Zhupa – Një sqarim në lidhje me pyetjen time për të drejtat televizive, i referohem faktit që RTSH-ja ka blerë të drejtat televizive për lojërat dimërore dhe ia ka shitur këto një televizioni tjetër privat kombëtar. Ju pyeta për këtë, se po raportoni për vitin 2021, për të gjithë vitin, duke iu referuar këtij precedenti, ju pyeta në lidhje me të drejtat televizive dhe atë që ju mendoni se do të jetë praktika. Meqenëse më përmendët rastin e Kampionatit Botëror që RTSH-ja ka blerë të drejtat, a mund ta di se sa ka kushtuar?

Enkelejd Joti – Nuk jam i saktë në shifër, për informacion ne e kemi blerë nëpërmjet EBU-së, *European Broadcastin Union*, që është shoqata e të gjitha televizioneve publike të Europës, e blen këtë të drejtë dhe është fat, sepse nëse do të shikonim çdo televizion më vete, do ta kishim shumë të vështirë ta realizonim. Si funksionon? Ne japim ofertat tona, aktualisht kemi dhënë një ofertë për olimpiadën e ardhshme, ia japim EBU-së, pasi e mëparshmeja është marrë nga Eurosporti dhe ka pasur çmime shumë të larta, që ne, për shkak të situatës financiare, nuk i kemi blerë. Njëri prej tyre ishte e dhjetorit në Kinë, për të cilën nuk kishim asnjë interes qoftë nga ana financiare, qoftë për kohën e transmetimit, sepse ishte pas orës 24:00 të natës deri në orën 06:00 të mëngjesit dhe, ne përveç një skiatori, një shqiptari që jetonte në Itali, nuk kishim asnjë pjesëmarrës. Kjo na krijon probleme për Parisin, që është në muajin qershor, por vlerat ishin shumë të larta dhe ne nuk i përballonim dot, ndërsa në vijim është EBU-ja që konkurron *on block* për të gjitha televizionet publike, ku ne kemi dhënë ofertën tonë, të cilën do ta ofrojnë për të gjitha televizionet publike.

Kjo është forma e blerjes. Të drejtat televizive kanë një kapërcim shumë të madh dhe ne si televizion publik kemi detyrim për të transmetuar, por duhet të ketë edhe mbështetje financiare. Nëse do të kemi detyrimin për ta transmetuar, sepse kanë kapërcyer jo pak, në 2-3-fish, është një gjë e pamundur të konkurrojmë me platforma digjitale, sepse ata i shesin në fund fare, kurse ne...

Petro Koçi – Kjo do të jetë e drejtë ekskluzive.

Enkelejd Joti – Cila?

Petro Koçi – Kampionati Botëror.

Enkelejd Joti – Kampionati Botëror, po, por po flas për evente të tjera sportive në vijim.

Petro Koçi – Faleminderit!

Zonja Zake e ka fjalën.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e RTSH-së për prezantimin!

Unë do të ndalem jo në opinionet, pyetjet e përgjithshme lidhur me politikën dhe strategjitë e RTSH-së, por saktësisht te raporti vjetor 2021, si dhe në analizën e Shërbimit të Monitorimit. Dihet që RTSH-ja drejtohet nga 3 organe vendimmarrëse kolegjiale që është Këshilli Drejtues, drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit. Një shqetësim imi, që e citoi edhe kryetari i Këshillit Drejtues, është që Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, që mendoj se fillojnë edhe problemet në pjesën e monitorimit dhe analizës financiare, raporton direkt tek titullari i njësisë publike, që është drejtori i Përgjithshëm, ndërkohë që Drejtoria e Auditimit është një drejtori e pavarur, që ka varësi direkte nga drejtori i Përgjithshëm. Kjo drejtori raporton te ky drejtor, ndërkohë që kjo drejtori, për aq kohë sa duhet të monitorojë edhe veprimtarinë e drejtorit të Përgjithshëm, duhet të raportojë te Këshilli Drejtues dhe te Bordi i Administrimit, si organe kolegjiale dhe organe vendimmarrëse që janë. Për aq kohë sa Bordi i Administrimit merret me analizimin dhe veprimtarinë financiare, administrative të këtij institucioni ose këtij entiteti publik, përveç pjesës së programacionit, që drejtohet nga Këshilli Drejtues, por edhe në referencë të nenit 4, pika 11, të Këshillit Drejtues, si dhe në përputhje me ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” duhet të bëhen rregullime ligjor. Mendoj se kjo duhet të përfshihet edhe në rregulloren e Bordit të Administrimit, nuk e di nëse ekziston apo jo, dhe këto rregullime do të çojnë në përmirësimin e punës dhe në monitorimin e aktivitetit të RTSH-së, kryesisht në atë financiar.

Kam 2 pyetje lidhur me drejtorin e Përgjithshëm që, ndoshta, me rregullimet e mëvonshme mund të jenë pjesë edhe e Këshillit Drejtues dhe e Bordit të Administrimit. Çfarë masash janë marrë lidhur me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, pasi në raport thuhet që detyrimet e prapambetura ndaj palëve të treta janë 136,1 milionë lekë, ndaj Ministrisë së Financave janë 1 miliard e 700 milionë lekë dhe ndaj *Deutsche Bank* është 975,5 miliardë lekë? Çfarë masash janë marrë, dhe meqë sapo keni marrë detyrën, çfarë masash do të merrni lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së?

Kam edhe një pyetje tjetër që ka të bëjë me numrin e punonjësve. Nga raporti rezulton se numri i punonjësve në total i miratuar me organikë, jo ai efektiv, është 1040 punonjës të miratuar në vitin 2021, pra ka pasur një rritje të numrit të punonjësve, gjë që është reflektuar edhe në rritjen e efektit të pagave, pasi edhe pagat janë rritur në masën 11% në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Kur ka qenë rritja e fundit e pagave të punonjësve të RTSH-së? A parashikohet rritja e numrit të punonjësve në përmirësimin e performancës së RTSH-së?

Shpenzimet financiare për pagat në tabelat që na janë paraqitur janë në vlerën 915 milionë, duhet të jetë, pasi është e shprehur në mijë lekë, në krahasim me 824, që ka qenë në vitin 2020 dhe në vitin 2019 ka qenë më e ulët. Kjo vjen si rrjedhojë e rritjes së nivelit të pagës të vitit 2021 në masën 11%. Një pyetje: vjen edhe si rrjedhojë e rritjes së numrit të punonjësve, apo është vetëm efekti i rritjes së pagave? A parashikohet rritje apo ulje e numrit të punonjësve për vitin 2022 në përmirësimin e punës, cilësisë dhe performancës së institucionit tuaj?

Petro Koçi – Zgjidhni vetë sipas pyetjeve dhe përgjigjet.

Pandi Madhi – Do të përpiqem të bëj një sqarim për çështjen e pagave.

Rritja e pagave, indeksimi i pagave, se kishte 6-7 vjet pa u ndryshuar pagat, u bë në shtator të vitit 2019, 10% për pagat nën 50 mijë lekë të rinj në muaj dhe 6 mijë lekë për pagat mbi 50 mijë lekë. Kjo ishte rritja e fundit e pagave.

Për dijeninë tuaj, niveli i pagës mesatare në RTSH është 10 mijë lekë të rinj në muaj më pak se niveli mesatar i pagës në administratën shtetërore në tërësi në Republikën e Shqipërisë. Rritja e shpenzimeve për pagat vjen kryesisht edhe nga efekti i rritjes së pagë, siç jua thashë, por edhe nga indeksimi, por edhe nga rritja e numrit të punonjësve, mund të jenë 10-30 punonjës më shumë, plus minus 20-30 janë, varet nga situata, nga muajt, kur dalin punonjës në pension, pra lidhet me shumë faktorë.

Petro Koçi – Po, zoti Joti.

Enkelejd Joti – Lidhur me masat e shlyerjes së detyrimeve, nëse RTSH-ja nuk prodhon projekte artistike, nuk besoj se do të kemi ndonjë të ardhur shtesë, ku është një nga zërat e rëndësishëm që janë reklamat. Siç e përmendi edhe kryetari i bordit, buxheti i RTSH-së përbëhet nga reklamat, nga marketingu, nga tarifat dhe nga buxheti i shtetit. Ky i fundit çdo vit ka qenë në rrudhje. Fatkeqësisht, këtë vit, zëri “investime” është zero, që është aspak normale. Duke marrë në konsideratë atë infrastrukturë që kemi, unë mendoj se ai staf atje po përpiqet të bëjë një punë heroike, për t’iu përgjigjur standardeve që kërkon tregu mediatik. Pa një financim paraprak, që nënkupton realizimin e projekteve artistike për një periudhë kohe që opinionin publik, bizneset binden që RTSH-ja po prodhon, kur të projektojë buxhetin e reklamave për vitin në vijim të mendojë një pjesë të këtij buxheti për RTSH-në, pasi do ta kemi shumë të vështirë. Unë do të marr vetëm një element, edhe RTSH-ja në vitin 2012 kur ka filluar tarifa të vilet nga OSHE-ja, ka pasur një kanal televiziv tokësor, një satelitor, një radio dhe ka pasur një buxhet më të madh sesa ky që kemi aktualisht me 18 kanale televizive, 12 kanale radio dhe të tjera me radhë. Pra, nuk është aspak normale dhe janë hequr, përveç kësaj, siç e tha edhe kryetari i bordit, gati 5 milionë dollarë nga kredia dhe nga mirëmbajtja që paguajmë çdo vit. Prandaj, nëse nuk do të kemi një rritje të buxhetit për të prodhuar projekte artistike, ne do ta kemi shumë të vështirë për të realizuar objektivat tonë.

Ndërsa lidhur me zbatimin e KLSH-së, e përmenda disa herë që natyrisht është detyra jonë funksionale që ato t’i kemi në referencë dhe kemi filluar t’i zbatojmë që nga momenti që kam filluar detyrën dhe në vazhdim, jemi në proces dhe bëjmë raportimet tona në KLSH, e kemi detyrim ligjor për të informuar për masat që kemi marrë në zbatimin e vendimeve të tyre.

Petro Koçi – Faleminderit!

Zonja Tahiraj, më pas zonjat Bakiu dhe Buxheli.

Dasantila Tahiraj – Faleminderit, zoti kryetar!

I vlerësoj të gjitha shpjegimet dhe përgjigjet që dha zoti Joti, së bashku me stafin që e shoqëron. Gjej me vend të vlerësoj emisionin “RTS Shkolla”, i cili ishte shumë i vlefshëm në 2 vjet pandemi dhe e shikojmë me shumë interes për nxënësit e klasave kolektive, që janë në një numër shumë të madh, vazhdimin e këtij emisioni në vitin e ardhshëm shkollor, duke u nisur nga fakti që është i vetmi televizion që merr taksa nga të gjithë shqiptarët. Pyetjet e mia konsistojnë në aspektin financiar, kam 3 pyetje të thjeshta.

E para, sa është përqindja e shpenzimeve direkte të përdorura për programacionin? Nga këto, sa janë për programacion artistik dhe sa për të tjerat? Sa për qind zënë në buxhet shpenzimet indirekte? Sa është përqindja e të ardhurave nga reklamat në buxhet dhe nisur nga investimet që janë bërë në teknologji, sa është rritur audienca dhe cila ishte pritshmëria e arritjes?

Faleminderit!

Petro Koçi- Zoti Madhi, fjala për ju.

Pandi Madhi- Lidhur me përqindjen që zënë projektet në shpenzimet, projektet artistike dhe filmike janë 2,3 miliardë lekë të reja që i zgjidhë buxheti i RTSH-së llogaritet 14-1% e shpenzimeve. Shumica e tyre janë shpenzime direkte, si paga, sigurime shoqërore, programet, shpenzime energjie elektrike, ujë, telefona, por edhe pagesat direkte ndaj institucioneve ndërkombëtare EBU-së e të tjerë shkojnë rreth 600-700 mijë euro në vit. Pra, janë disa institucione ndërkombëtare që RTSH-ja është detyruar t'i paguaj kuotat çdo vit. Kështu që mendoni se shpenzime indirekte mund të mbeten shumë pak, një përqindje shumë e vogël. Këto i shërbejnë të gjitha institucionit dhe pjesa tjetër e reklamës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E thashë, 14-15% e shpenzimeve...

Dasantila Tahiraj - Pyetja ime ishte shumë qartë e përcaktuar, cili është buxheti që vihet në dispozicion të programacionit direkt për shqiptarët? Pra, është një shifër shumë e ulët dhe rentabiliteti i një institucioni duket se cili është produkti përfundimtar, nuk ka rëndësi që paguhen pagat, produkti përfundimtar është ky.

Pandi Madhi- Ky ishte shqetësimi i kryetarit të Këshillit dhe i drejtorit të Përgjithshëm lidhur me pjesën e shpenzimeve që realizohen për projekte artistike dhe filmike.

Pyetja e fundit lidhur me reklamat, a to zënë afërsisht 7% të të ardhurave. Për vitin 2021 janë realizuar 143,5 milionë lekë dh enë të ardhurat gjithsej, bashkë me financimin e buxhetit është 2 miliardë e 233 milionë, pra, më pak se 10%.

Leka Bungo- Më fal se po ndërhyj!

Për ta përkthyer. Sa ka reklama Blendi Fevziu në një mision, aq ka e gjithë RTSH-ja gjithë vitit.

Pandi Madhi - Kjo është pak e ekzagjeruar, zoti Bungo.

Dasantila Tahiraj - Nëse shohim, programacioni artistik merr...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Programacioni artistik është 14%, reklama 7%. Pra, ka një lloj përqindjeje që ecën paralelisht. Pra, sa ka programacion artistik, aq ka edhe reklama.

Kam edhe një pyetje lidhur me burimet njerëzore. Ju thatë që keni një numër punonjësish 1040 të miratuar, ky numër punonjësish çfarë programacioni prodhon?

Enkelejed Joti - Aktualisht, është programacioni që kemi *online* dhe, natyrisht, në faqen e internetit janë të gjitha programet që ne aktualisht kemi *on air*. Këtu nuk janë vetëm 1040 punonjës, por duhet të llogarisim që janë edhe 4 qendra vendore,. që është Shkodra, Gjirokastra, Korça dhe Kukësi, që kanë mesatarisht 25-30 veta, si dhe është edhe stafi teknik...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, kanë radiotelevizion, por janë bërë televizione vitet e fundit, ku Shkodra ka filluar në majin dhjetor të transmetojë edicione lajmesh. Kështu që nga 1040 punonjës një pjesë e tyre janë pjesë krijuese që janë televiziv, qoftë për gazetarë, apo realizimin e programeve artistike, ato që ne kemi.

Aktualisht, ne po bëjmë këtë ristrukturim, sepse kemi pasur probleme, pasi një pjesë e stafit të punonjësve nuk kanë pasur ngarkesën e duhur dhe një pjesë kanë pasur mbingarkesë dhe ndonjëherë u detyronim të merrnim edhe punonjës nga jashtë edhe pse kishim staf të brendshëm, pasi kanë pasur detyra të qarta. Kështu që me këtë ristrukturim presim që të rritet rendimenti i të gjithë stafit. Nëse do të ishin të gjithë kanalet që të prodhonin, janë pak 1000 punonjës.

Petro Koçi- Faleminderit!

Fjalë e ka zonja Bakiu, pastaj zonja Buxheli.

Për procedurë fjalën e ka kërkuar zonjusha Ulliri.

Andia Ulliri- Faleminderit!

Dua të bëj një saktësim. Në momentin që unë dhe zonja Zhupa bëmë pyetje për punësimet, pavarësisht se patëm një përgjigje të tërthortë, në nenin 102...

Petro Koçi- Nuk është për procedurë.

Andia Ulliri - Në nenin 102, përcaktohet që drejtori i Përgjithshëm për veprimtarinë e RTSH-së emëron, liron dhe shkarkon, në përputhje me ligjin që rregullon marrëdhëniet e punës të gjithë vartësit e tij, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj në statutin e RTSH-së parashikohet ndryshe. Pyetja jonë është në përputhje me ligjin dhe ishte mbi faktin që ju keni emëruar, liruar apo shkarkuar njerëz me vullnetin tuaj të plotë, duke qenë se këto janë të drejtat dhe detyrat që

drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së posedon. Ju mund të mos përgjigjeni, por besoj se publiku shqiptar e ka marrë përgjigjen për pyetjet e mëparshme.

Petro Koçi- Zoti Joti e ka fjalën. Pastaj zonja Zake për procedurë.

Enslmvera Zake - Patjetër që në çdo institucion apo ent publik titullari i njësisë publike emëron ose shkarkon punonjësit nga detyra, sepse këtë ia përcakton ligji, por procedurat për emërimin, lirimimin apo shkarkimin nga detyra i bën drejtorja e Burimeve Njerëzore, e cila ka edhe detyrimin ligjor për shpalljen e pozicioneve vakante, ngritjen e komisioneve *ad hoc*, siç e thatë edhe ju, të cilat pas shpalljes mbledhin kandidaturat; ky komision vlerëson pikëzimin dhe në fund shpallet fituesi. Detyrimin ligjor e ka drejtori për të firmosur vendimin e emërimit, por procedurat nuk i kryen drejtori.

Petro Koçi- Faleminderit!

Zonja Bakiu, fjala për ju.

Merita Bakiu- Faleminderit, drejtues i seancës!

Unë e shoh që zgjati si seancë dhe nuk dua të zgjatem shumë, pasi shumica e pyetjeve u bënë. Unë besoj se të gjithë duhet të jemi në ndihmë të asaj që ju kërkoni, në mënyrë që të rritet cilësia e RTSH-së, sepse është një aset kombëtar.

Nga të gjitha relacionet që na janë dhënë, edhe nga relacioni nga KLSH-ja, pretendohet që janë hequr njerëz nga puna, të cilët kanë hapur procese gjyqësore. Sa i kushtojnë buxhetit të shtetit këto procese gjyqësore që janë hapur?

Kemi diskutuar për të drejtat e autorit në këtë komision dhe këtu është përmendur që ka një konflikt midis RTSH-së dhe Drejtorisë të Drejtave të Autorit në lidhje me përlogaritjen e tarifave të të drejtës së autorit. Cila mund të jetë zgjidhja për këtë konflikt midis jush dhe Drejtorisë së të Drejtave të Autorit?

Faleminderit!

Petro Koçi- Po, zoti Joti.

Enkelejd Joti - Lidhur me kostot e shkarkimeve, kjo nuk është në total, pasi ato janë procese që ndiqen në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe në momentin që ka një vendim të formës së prerë, atëherë ato zbatohen. Unë nuk jam i përgatitur t'ju jap një kosto të saktë se sa ka qenë gjatë vitit 2021. Unë mund të marr informacion dhe t'ju sjell zyrtarisht këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, por janë procese në vijim.

Lidhur me të drejtat e autorit, në një takim që kam pasur me disa përfaqësues të të drejtave të autorit, të cilët kërkonin të merrnin një përqindje, 2 ose 3%, të të gjitha të të ardhurave që kishte RTSH-ja, e cila m'u duk absurde. Për këtë ne kemi ngritur një ekip brenda RTSH-së, ku juristët, të cilët janë ekspertë të fushës, në konsultim me Ministrinë e Kulturës dhe në diskutimet që kanë pasur me përfaqësues të të drejtave të autorit, për të riparë kërkesat e tyre, sepse për mendimin tim, sidomos në stadin aktual që është RTSH-ja, është e pa logjikshme. Megjithatë, ne jemi të detyruar të respektojmë ligjet në fuqi, por edhe t'i propozojmë për ndryshimet për ato që ne i quajmë të palogjikshme. Kështu që jemi diskutuar me ministrinë e Kulturës dhe Shoqatën e të Drejtave të Autorit dhe në momentin që do të kemi nevojë edhe për komisionin, ne do t'i drejtohej edhe komisionit.

Petro Koçi- Megjithatë, ne sapo e kemi parë ligjin për të Drejtat e autorit, për agjencitë e administrimit kolektiv, kështu që duhet parë dhe t'u thoni juristëve që ligji ka ndryshuar dhe ta shohin me vëmendje.

Zonja Buxheli, fjala për ju.

Lindita Buxheli- Një pjesë e pyetjeve u ezauruan nga parafolësit. Dua të falënderoj stafin, në veçanti zotin Leka, meqenëse e kemi pasur në qytetin e Lushnjës regjisor! Nuk dua t'i bëj komplimente zotit Bungo, por për kohën ishte risi futja e elementeve europiane në skenën lushnjarë.

Faleminderit, zoti Leka!

Pyetja ime është: nisur nga biseda që kam bërë me një televizion lokal që është hapur para 7-8 muajsh, të cilët ankoheshin se paguanin kuotën rreth 2 mijë euro për TVSH-në. Dua të di kjo shumë prej 2 mijë eurosh futet tek të ardhurat nga shfrytëzimi në infrastrukturë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kuptoj, por kjo i vë në vështirësi, sepse TV4plus u mbyll në Lushnjë për 3 vjet rresht, për shkak të kësaj mospagese prej 2 mijë eurosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe këtë pjesë e kuptoj. U rihap prapë, por përsëri janë në të njëjtën situatë, është e njëjta vështirësi që gjendeni ju në përmasa më të mëdha dhe kjo është pjesë jona për ta riparë, kur të hartohet projektbuxheti dhe unë jam pro për të dhënë të gjithë ndihmesën si anëtare e këtij komisioni, por në të njëjtën situatë gjenden edhe televizionet lokale dhe ju e kuptoni shumë mirë se në çfarë vështirësish ndodhen ato.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po e bëj si pyetje se cili zë e ka këtë, të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës?

Petro Koçi - Faleminderit, zonja Buxheli!

Pandi Madhi - Të ardhurat janë të përfshira edhe në raporte, i cili është një zë i rëndësishëm i të ardhurave. Tarifat janë përcaktuar nga AMA, kështu që për sa kohë ata e përdorin atë infrastrukturë, ku në bazë të tarifave edhe paguajnë.

Petro Koçi - Zoti Spaho, pyetjen e fundit.

Florenc Spaho - Faleminderit kryetar!

Në respekt të të ftuarve, më vjen mirë që të gjithë kolegët e maxhorancës dhe opozitës drejtojnë pyetje dhe duan të marrin nga ekspertiza e këtyre njerëzve të nderuar që kanë treguar se kanë dhënë shumë në fushat respektive profesionale, por edhe si drejtues.

Jam besimplotë që situata do të ndryshojë dhe shpresoj që të ndryshojnë edhe situatat botërore, sepse është fakt që këto situata na kanë vënë përpara vështirësive. RTSH-ja është një aset kombëtar, është një krenari jona; që të gjithë duam të kontribuojmë dhe të japim idetë dhe mendimet tona më të mira se si duhet të jetë edhe mbarëvajtja e punëve.

Më vjen mirë që në drejtim të RTSH-së ka njerëz që kanë dhënë shpirtin dhe kontributin e tyre, siç është profesor Leka Bungo, i nderuari zoti Mevlan Shanaj, të nderuarit e tjerë që janë këtu, të cilët kanë treguar që kanë ditur të drejtojnë institucione edhe më të rëndësishme dhe vazhdojnë të drejtojnë një institucion, siç është RTSH-ja, por bashkohem me mendimin e kolegëve që duhet të ketë rifreskim apo rregullim sa i përket punësimeve, që të tërhiqen ata njerëz, të cilët duan të kontribuojnë te ky aset kombëtar. Patjetër që ekonomia është ajo që vërtet çdo gjë, por besoj se ka njerëz, të cilët mund të gjejnë një formë që të kontribuojnë për këtë aset kombëtar, pse jo edhe kur është për të minimizuar edhe numrin e punonjësve, të cilët rrinë, ose nuk bëjnë punën. Duhet dhe të ketë një rifreskim total sa u përket punësimeve.

Pyetja ime e drejtpërdrejtë është për te tre drejtuesit e nderuar të organeve. Kuadri ligjor për funksionimin e RTSH-së dhe organeve drejtuese varet nga Këshilli Drejtues, drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit. Çfarë duhet ndryshuar në marrëdhënie me këto të tre organet? Çfarë duhet që në nivel institucional të ketë diçka që të funksionojë më mirë ndërmjet jush, në mënyrë që të reflektohet edhe në nivel të atyre me të cilët ju punoni?

Faleminderit!

Petro Koçi - Faleminderit, zoti Spaho!

E lamë që të bënit një pyetje të shkurtër për përgjigje të shkurtër, por bëtë një pyetje për tri përgjigje.

Enkelejd Joti - Për t'iu përgjigjur pyetjeve, unë dua t'ju them se në momentin që ne do të kemi mundësi financiare për të realizuar programe, debatet tona nuk do të jenë a do të bëjmë apo jo programe, por cili do të jetë kualiteti i programeve. Ne, aktualisht, kemi debate jo të vogla dhe i themi njeri-tjetrit që duhen bërë programe, por që të realizohen këto programe duhen edhe mbështetje financiare. Në qoftë se na duhet të marrim njerëz të konfirmuar në treg, ata duhen paguar dhe është e vështirë që ne të konkurrojmë me pagat që aktualisht kemi. Flas për pagat e të njëjtit nivel dhe nuk flas për konkurrencën e televizioneve private. aktualisht, ne kemi një orkestër ,e cila është e vetmja në Shqipëri, orkestrën simfonike, e cila është një nga vlerat e RTSH-së, që ka bërë 60-vjetorin këtë vit dhe për të, fatkeqësisht, kemi një nivel page më të ulët sesa e ka Teatri i Operës dhe Baletit. Nëse në Teatrin e Operës dhe Baletit premtohet se do të rritet edhe 10% paga mbi këtë nivel rritje page që ka aktualisht, mund të ketë edhe tendenca që të ikin edhe ato vlera që ne kemi brenda asaj orkestre, ku ka pasur raste që edhe kanë ikur. Kështu që, kryesorja e mbarëvajtjes është financimi, në mënyrë që ne të bëjmë debate kualiteti deh jo debate ekzistence, sepse aktualisht, mund t athem edhe me plot gojë, që ka të bëjë edhe me ekzistencë.

Petro Koçi - Po, zoti Bungo.

Leka Bungo - Më doli nga mendja që të them një kërkesë, të cilën e kam bërë 3 herë brenda një viti: herën e parë me gojë, të dytën me shkrim Kryetares së Kuvendit, që nuk është marrë në konsideratë dhe sot në komision.

Në Shkodër thonë “Lypa faqen e zezë e ka, por pa gjë s'të len”. Shikojeni mundësinë për t'ua rritur honorarin anëtarëve të Këshillit Drejtues, sepse ai shpërblim, sepse nuk është adekuat, nuk është si për të gjitha institucionet e tjera, ai shpërblim nuk i detyron anëtarët e Këshillit Drejtues, siç i detyroj unë, që të vijnë në mbledhje deri në 4 herë në muaj, kur në ligj e kanë edhe 1 herë në dy muaj. E them sinqerisht që ata janë mbledhur edhe 4 herë në muaj, sepse të tilla kanë qenë problemet dhe mund të jenë edhe më të shumta. Ju nuk i doni për vete paratë, ne i duam. Është e treta herë që e bëj këtë kërkesë, prandaj, vini dorë në zemër, në kuptimin shtetëror, që të bëhet diçka për këtë problem. Nëse doni të më përjashtoni mua, mund të më përjashtoni, sepse unë jam qytetar amerikan dhe nuk merrem me pensionet këtu, por për anëtarët e Këshillit Drejtues, ju lutem shumë, shikojeni! Nuk është serioz, por ju e keni....

Petro Koçi - Faleminderit!

Besoj se ia vlejti e gjithë kjo lodhje e të gjithëve për të dëgjuar raportimet nga titullarët e trupave që përbëjnë RTSH-në, ekzekutivi, Këshilli, bordi i administrimit, por edhe anëtarin e nderuar, zotin Shanaj. Besoj se edhe pyetjet ishin me shumë interes për të zgjuar më shumë vizion për të gjithë komisionin, por edhe për të qenë më realistë lidhur me situatën aktuale në RTSH. Të gjithë kemi pretendime ndaj RTSH-së, ashtu siç janë të drejta edhe një pjesë e pretendimeve, sidomos për mbështetje financiare nga vetë televizioni përkundrejt shtetit, apo institucioneve të tjera, si: qeverisë dhe Kuvendit. Sigurisht që ne do të vazhdojmë në një mbledhje tjetër, ku do të merremi me rezolutën përkatëse, që do t'i propozojmë seancës plenare, por unë dua të falënderoj jo vetëm anëtarët e komisionit, por edhe ju për gjithçka që kontribuat sot në këtë mbledhje!

Shpresoj të takohemi serish dhe të kemi mundësinë që edhe ndonjë kërkesë specifike të jetë plotësuar ndërkohë, sepse, në fakt, motivimi financiar është një mekanizëm i vlefshëm jo vetëm për ata që janë protagonistë të ekranit, por edhe të përbërjes së Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit, sepse, në fund të fundit, janë njerëz me shumë personalitet dhe besoj që edhe përgjigjja financiare duhet të jetë në përputhje me dinjitetin e tyre.

Ju falënderoj shumë dhe mirupafshim në mbledhjen tjetër!

MBYLLET MBLEDHJA

